

Dukagjini "Nderi i Kombit"



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XV i botimit, nr. 181, Nëntor 2018
Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355674001940, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Suela Ndoja, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

5 Papa Françesku pret delegacionin shqiptar, vlerëson Skënderbeun

Në pritjen e pelegrinëve shqiptarë të mbërritur në Vatikan për 550-vjetorin e Skënderbeut, Papa Françesku ka përkujtuar me superlativa heroin kombëtar shqiptar, duke e cilësuar hero të vlerave shpirtërore dhe shpëtimtar të krishtërimit.

Shqipëria, një tokë antike dhe me një histori të lavdishme, është pjesë integrale e Europës dhe përmes traditave të saj më fisnike dokumenton origjinën e qytetërimit të saj. Me këto fjalë ati i shenjtë Papa Françesku ka përshëndetur delegacionin e pelegrinëve të mbërritur në Romë nga Shqipëria, me rastin e 550-vjetorit të vdekjes së heroit kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu.



Kongresi i Manastirit dhe shqipja letrare (110-vjetori i Kongresit të Manastirit)

10

Në vitin jubilar të 110-vjetorit të lindjes të shkencëtarit e të gjuhëtarit të madh Prof. Eqrem Çabej, është edhe ngjarja e madhe dhe e shënuar në historinë e kulturës shqiptare e Kongresit të Manastirit, hartimi dhe përgatitja e një alfabeti me të cilin do të shkruhej gjuha shqipe.

Ishte një nga detyrat e mëdha dhe të vështira e gjuhëtarëve, e shkrimtarëve dhe në përgjithësi e të gjithë intelektualëve eruditë shqiptarë në dheun amë apo të huaj për të pasur një alfabet të tyren dhe me kahje të hapur për të shkruar e botuar shqipen me lehtësi e ku të pasqyrohej e gjithë dinamika e saj në rrymë të viteve.

DITA E PLISIT në Mitrovicë e Boletin

2

E shtune, 27 tetor 2018 në përvjetorin e peste të Ditës së Plisit në Kosovë, mori pjesë dhe një grup nga Shoqata Atdhetare "Dukagjini", Ndue Sanaj, Prel Milani, Kole Çardaku, Gjon Kosteri e Ndoc Fusha. Ishte ora 10. 30, kur nga të gjitha trevat e Shqipërisë së Veriut, filluan të vijnë në Mitrovicën historike e heroike, të veshur si për dite feste, të rinj e të reja, burra e gra qeleshe bardhe, krenar e kryelarte, shume prej të cilëve me veshje tradicionale të qëndisura me ngjyra të ndryshme, me Flamurin Kombëtar, me sharki, çifteli e fyeje nder duar duke vërshuar ...

Në Pejë


Me datën 11 nëntor 2018, dite e diele, në ora 14. 00 deri në ora 18. 00, Shoqata e Miqësisë Kosovë-Malësi e Madhe "Martin Dreshaj", me qendër në Pejë, është organizatorja e vepërimitarisë kulturore, në kuadrin e vitit të Gjergj Kastriotit, me teme: "100 vjetori i Komitetit për mbrojtje e Kosovës dhe festave të Nëntorit, në shenjë respekti dhe kujtimi për të gjithë mësimdhënësit e brezave, me qellim që ne të shkruajmë dhe të flasim shqip..."

DOM LAZER SHELDIA MODEL BASHKIMI, VLLAZNIMI E MIRËKUPTIMI

6

Dom Lazër Sheldia kishte një ëndërr të madhe për t'i bashkuar të gjithë shqiptarët rreth shtëpisë së Zotit. Ai ishte një mikpritës dhe bujar shembullor. Çdo emigrant që ka shkuar për të kërkuar ndihmë tek ai, i ndihmonte pavarësisht besimit fetar që ata kishin, mjafton që ata të ishin shqiptar, sepse e kuptonte shumë mirë se rruga dhe mundimet e emigrantëve nuk kanë të sosur, Dom Pjetër Popaj; famullitari i Kishës Katolike "Zoja e Shkodrës" në New York meshtar dhe aktivist i përkushtuar.

Malësorët e Malësisë së Madhe me malësorët e Dukagjinit prej kah rridhte Dom Lazri, më parë se lufta e mërgimi, i bashkoi mesha e meshtari dhe ma parë se mesha e meshtari...



Pema e dëshirave: shëmbëlltyra që na tregon se si i sabotojmë jetët tona

Brenda pak kohe, a iu lodh, u ndal për të pushuar në hijen e një peme, pa e ditur se ishte një pemë magjike, e cila u ka realizuar menjëherë të gjitha dëshirat e atyre që rrinin afër. Duke u ndier shumë i etur, donte të pinte ujë me akull. Në të njëjtin moment, në dorën e tij u shfaq një gotë uji. Shumë i befasuar, ai shuajti etjen e tij. Pastaj e kuptoi se ishte i uritur dhe, sapo donte diçka për të ngrënë, një pjatë e shqumimit u shfaq para tij. Menjëherë njeriu e kuptoi se po ndodhte diçka, të gjitha dëshirat e tij po plotësoheshin.

11

DITA E PLISIT në Mitrovicë e Boletin

E shtune, 27 tetor 2018 në përvjetorin e peste të Ditës së Plisit në Kosovë, mori pjesë dhe një grup nga Shoqata Atdhetare "Dukagjini", Ndue Sanaj, Prel Milani, Kole Çardaku, Gjon Kosteri e Ndoc Fusha. Ishte ora 10. 30, kur nga të gjitha trevat e Shqipërisë së Veriut, filluan të vijnë në Mitrovicë historike e heroike, të veshur si për dite feste, të rinj e të reja, burra e gra qeleshe bardhe, krenar e kryelarte, shume prej të cilëve me veshje tradicionale të qëndisura me ngjyra të ndryshme, me Flamurin Kombëtar, me sharki, çifteli e fyeje ndër duar duke vërshuar grupe – grupe në sheshin ku është vendosur monumenti i Isa Boletinit, sheshi "I Isa Boletini", në qytetin heroik të Mitrovicës, duke hijeshuar rrugët e sheshit për rreth përmendores madhështore të kreshnikut kapuç-bardhe, të lavdishëm të maleve të Kosovës, të Shqipërisë duke shtrënguar duart e uruar mirëseardhjen, dhe duke shkrepur kamerat e aparateve fotografike me njeri-tjetrin.

Vërshuan kapuç-bardhet e maleve, kryelartë, të papërkulur, të paepur e faqebardhe, kokëthinjur si kreshtat e Alpeve me bore, duke rrethuar si dikur krah-shtrënguar Bacën Ise, në lufte për të mbrojtur çdo pëllëmbë toke të atdheut tone të lavdishëm nga pushtuesit e huaj, të cilët asnjëherë nuk pushuan duke nxjerre helm, duke intriguar e nxitur përçarjen e vëllavrasjen, me qellim dobësimin, varfërinë, prapambetjen, copëtimin e pushtimin më lehte të trojeve tona etnike aq të pasura me burime të shumta nëntokësore e mbitokësore të pashfrytëzuara.

Dita e Plisave, kapuçave, kapticave e qeleshe bardhe prej leshi deleje të ngjeshur e bere plis si zhguni i malësorit shqiptar në forme konike, me maje të rrumbullaket, si gjysme sferë-vezore i rrahur në cumra konike prej druri të formës së vet dhe të lare fort me shkume sapuni e bere të bardhe si bora në male; është simboli i zemrës së bardhe të malësori kryelarte e kokëthinjur; është simboli i burrërisë, ndershmërisë, besnikërisë, trimërisë, qëndresës së paepur, këmbënguljes së patundur, krenarisë për familjen, vendlindjen, krahinën e atdheun. Ti heqësh apo ti marrësh me force qeleshen e bardhe burrit, është si ti marrësh pushkën, si ti marrësh nderin, si ta përulesh, nënshtrosh e robërosh, prandaj duhet mbajtur përherë krenar, i pashtypur, kryelarte plisa bardhe, si malet kreshte thinjura.

Kështu, të bashkuar plisa-bardhet rreth përmendores së Isa Boletinit, ku u vendosen kurora me lule, vargu i qeleshe-bardhëve mori rrugën për në Boletin, ku ndodhen themelet e vjetra të kullës së Boletineve dhe shtëpia muze e rindërtuar, si dhe varri ku prehen përjetësisht eshtrat e Heroit të Popullit, Heroit të Lavdishëm, Isa Boletini, e ku u vendosen kurora me lule, u bën homazhe e shume fotografi

pranë e përkrah Ati, që kurrë nuk u përkul përballë asnjë armiku. Atij, që deri në përjetësim luftoi për liri e pavarësi kombëtare. Ai, që përkrah Ismail Qmalit dhe Luigj Gurakuqit, në Vlore ngriti Flamurin Kombëtar, duke shpallur Pavarësinë e Shqipërisë, me 28 nëntor

pranë njëra-tjetrës si kështjella heroike të qëndresës për liri, pavarësi e dinjitet kombëtar u mbushen plote e përplot dhoma e madhe, ku u mbajtën kumtesa për të pranishmit mbi krenarin e vlerat e Plisit të Bardhe, u recituan poezi, u kënduan kënge e u hedhen valle, të

jte, me 27 tetor 2018, në kullën e Heroit Kombëtar, Isa Boletini-Boletin

Në emër të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", përshëndeti Kryetari i Shoqatës, Ndue Sanaj, që në mes të tjerave theksoj: "Heroi i Popullit Isa Boletini, në këtë moment, që ne jemi në kullën e tij, që kjo veprimtari realizohet në kullën e tij, të mos ndalesh Kryesia për të nderuar këtë figure kaq të madhe të Kombit tone, me titullin "**Mehmet Shpendi**", të njërit nga figurat bashkëkohës të tij, siç e quan Dukagjini, "Gjenerali" i tij dhe i vrare nga e njëjta dore gjakatare, malazeze, me motivacion: "**Isa Boletini i dha kuptim luftës së shqiptarëve për Shqipërinë e Bashkuar. Vepra e Isa Boletinit është nderuar në çdo kohë në gjithë Shqipërinë etnike. Emrin e tij e mbajnë shkolla, rrugë, lagje e sheshe. Kulla e Isa Boletinit Kazermë dhe fortifikate Qëndrese..... Gjenerali me qeleshe të bardhë....!**"

Nuk mund të mos ndalet te një personalitet tashme mjaft e spikatur në mbrojtje të të drejtave të Njeriut, siç është i pamposhturi Halit Barani, me titullin "**Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare Dukagjini**", me motivacion: "**Për kontributin e dhënë në Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut, vëzhgues dhe dëshmitar i krimit Serb në Kosovë, në 10 vitet e fundit në zonën e Mitrovicës dhe ato përreth. Aktor, regjisor e veprimtar i palodhur i çështjes kombëtar**"

Në sheshin e oborrit të kullës muze u shtrua edhe një koktej, me shume llojshmëri ushqimesh për dhjetëra të pranishëm duke u shoqëruar me këngë patriotike, meloditë e bukura të instrumenteve popullore dhe foto të shumta midis vëllezërve, me grupe dhe së bashku ne mjediset e bukura brenda dhe jashtë kullës së Ises. Në këtë mjedis, si brenda e jashtë Kullës, Shoqata Atdhetare "Dukagjini" u paraqit me rapsodët Gjon Kosteri e Ndoc Fusha, të cilët nderuan ne dhe Shkodrën.

Duke e përmbyllur kështu një dite feste e paharruar, me shume mbresa dhe emocione në vargun e ditëve plot kujtime e histori të lavdishme për të kaluarën dhe optimizmin e shpresën për të ardhmen, për të cilën sakrifikuam jetën e tyre qindra e mijëra bij e bija të kombit shqiptar në gjithë hapësirat shqiptare.

Mundësoj pjesëmarrjen në këtë veprimtari, zoti Ndoc Fusha, të cilin e falënderojmë dhe e urojme me shprehjen popullore "Paçi e dhënçi!"

Përgatiti **Kolë Çardaku**



1912. Kështu do të qëndroi përherë nder shekuj kryelarte, me qeleshen e bardhe, i hijshëm, i dashur e simbol e shembull frymëzimi për brezat që vijnë, piramide e paprekshme.

Të gjithë bashkuar në Ditën e Plisit të bardhe për të pestin vit me radhe, në qytete e fshatra të ndryshëm historike të Kosovës. Këtë here, në Mitrovicë, në sheshin e qytetit, në Boletin, pranë varrit të Heroit e kullës muze të ngritur midis themeleve të kullës së vjetër

çilat u priten me shume emocione nga të pranishmit. Pastaj u dhanë tituj nderi: Mirënjohje e falënderime për të ftuar, aktivist të Ditës së Plisit, u shpërndanë dhe u shkëmbyen libra të rinj të autoreve të pranishëm.

Shoqata Atdhetare "Dukagjini" u nderuar me titullin "**Mirënjohje**" nga Teatri "Sander Prosi" – Mitrovicë, me motivacion: "**Për pjesëmarrje në Manifestimin Mbarëkombëtar, edicioni i pestë Dita e Plisit, që u mba-**

tani dhe aktivisti Pashko Guri.

Pas mbajtjes të dy ligjëratave, njëra mbi 100 vjetorin e themelimit të Komitetit për mbrojtjen e Kosovë, nga Frasher Racaj dhe tjetra mbi arsimimin e djemve e vajzave shqiptare,

në Kosovë dhe në gjithë hapësirat shqiptare, nga Rrahman Jashari; fjala ju dha kryetarit, Ndue Sanaj.

Pas fjalës së tij, me Prele Shytanin e Kole Çardakun u ndanë tituj e nderit, që ka dhë-

në Kryesia e Shoqatës sonë, me propozim të Kryesisë së Shoqatës "Martin Dreshaj":

Zoti Rrahman Jashari, me titullin "Mirënjohja Martin Camaj"; Martin Dreshaj (pas vdekjes), me titullin "Mehmet Shpendi"; Shaban Murat Jashari (pas vdekjes), me titullin "Mehmet Shpendi"; SBSHKU (Sindikates së bashkuar të arsimit, shkencës e kulturës), me titullin "Mehmet Shpendi" dhe me titullin "Mirënjohja Martin Camaj".

Nga grupi i shoqatave: Shoqata "Martin Dreshaj", Shoqata Atdhetare "Dukagjini", Ansambli Autokton "Rugova" dhe Drejtoria e Teatrit "Aleksandër Moisiu", nderuan me titull nderi "Mirënjohja", Luigj Shyti, Gjyste Shyti, Kole Çardaku, Prele Shytani e Aleks Dushi, me motivacionin "**Për kontributin e dhënë në arsimimin e brezave nder vite, në detyrën fisnike si mësues dhe drejtues të shkollave**".

Mundësoj realizimin e kësaj pjesëmarrje zoti Daniel Çardaku, të cilin e urojme, me urimin popullore "Paçi e dhënçi!"

Korespondenti i gazetës "Dukagjini"

Në Pejë

Me datën 11 nëntor 2018, dite e diele, në ora 14. 00 deri në ora 18. 00, Shoqata e Miqësisë Kosovë-Malësi e Madhe "Martin Dreshaj", me qëndër në Pejë, është organizatorja e veprimtarisë kulturore, në kuadrin e vitit të Gjergj Kastriotit, me teme: "**100 vjetori i Komitetit për mbrojtje e Kosovës dhe festave të Nëntorit, në shenjë respekti dhe kujtimi për të gjithë mësimdhënësit e brezave, me qellim që ne të shkruajmë dhe të flasim shqip. Gjithashtu dhe një nderim i veçantë për mësimdhënësit e viteve 90-të, që me sakrificat të mëdha i dolën balle për balle okupatorit serb dhe nuk lejuan mbylljen e vatrave mësimore**".

Në këtë veprimtari marrin pjesë: Shoqata e Vëllazërisë Kosovë Malësi e Madhe, me qëndër në Pejë; Shoqata Atdhetare "Dukagjini", Ansambli Autokton "Rugova" dhe Teatri "Aleksandër Moisiu", në Pejë dhe të tjerë.

Shoqata Atdhetare "Dukagjini", mori pjesë me Kryetarin, Ndue Sanaj; anëtarin e kryesisë, Kole Çardaku, anëtarin e shoqatës, Prele Shy-



Në veprimtarinë artistike “Festa Pukjane”

Me 28 tetor 2018, një grup nga Shoqata Atdhetare “Dukagjini”, i përberë nga Kryetari i saj, Ndue Sanaj dhe N/Kryetari Prele Milani, mori pjesë në veprimtarinë artistike, të pagëzuar me emrin “Festa Pukjane”, me ftese të grupit organizator, me në krye **Vladimir Prenga** e Rrok Gjoka, të cilët me mbështetjen e biznesmenëve të shumtë e të nderuar të Pukës, të cilët nuk janë të pakte, dhe të Bashkisë Pukë, me Kryetari Gjon Gjonaj, si dhe me pjesëmarrjen e artistëve të nderuar të Pukës e me gjere, me të cilët krijuan një atmosferë të mire.

Një qetësi e bukur siç është Puka tashme dhe i ri-konstruktuar, me pamjen mahnitëse që ja i ka fale Natyra, por dhe bashkia e saj kishte punuar dhe vijonte të punonte me shume vizion e fantazi për të pasur një qytet sa me të bukur dhe historik. Në ballin e qendrës së tij, qëndronte monumenti i Mësuesit të Popullit, Millosh Gjergj Nikolla, me Lulin e Vocërre.

Pjesëmarrja e shumë nga qytete të Shqipërisë të ftuar të ndryshëm e beri edhe me shume entuziaste. Gjithashtu të ftuarit ishte dhe Shoqata “Mirëdita”, kryetari i saj **Gjon Lleshaj** dhe kryetari i degës së Shkodrës, Zef Gjini, si dhe Shoqata Nikaj



Merturi, me kryetarin e saj, Mhill Gecaj.

Kjo feste u mbyll me një drekë të mire, me të cilin dashuri e respekti për njëri-tjetrin i rriti përmasat e kësaj feste.

Në këtë drekë përshëndeti dhe kryetari i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, Ndue Sanaj, që në mes të tjerave theksoj: “Kënaqësi që marre pjesë në festën e Pukës, në festën e kësaj treve, që 50 vjet më parë isha pjesë e juaj, për rreth dy vjet, me qendër “Te gështenjat”, dhe që në emër të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, së bashku me Prele Milanin, N/

Kryetarin e saj, t’iu përshëndesim dhe t’iu them: Motra e vëllezër pukjane, mire se ju gjetëm, gëzuar festën dhe me zemër të mire!

Nuk është e lehtë të merren nisma të tilla, por dikush duhet ti marri përsipër, se kemi nevojë për pak argëtim, se argëtimi na largon nga rutina e përditshme, na largon nga të këqijat e sotme dhe se nesër do të shohim më me perspektive të pasnesërmen, të ardhmen tone dhe të femijve tane.

Pra, argëtimi është pjesë e jetës dhe kemi nevojë për te. Prandaj, i përgëzoj



nismëtarët dhe i falënderojmë për ftesën! Faleminderit Vladimir Prenga!

Mundësoj pjesëmarrjen në këtë feste, Zef Gjini, kryetari i degës së Shoqatës “Mirëdita”, në Shkodër. Faleminderit i nderuar Zef Gjini!

Korrespondenti i gazetës “Dukagjini”

NJOFTIM

Me datën 24 nëntor 2018, në mjediset e bibliotekës së Muzeut, në Tiranë, u zhvillua Mbledhja e Përgjithshme e anëtarëve të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, dega e Tiranës.

Materialin e punës së degës për punën e degës në pesë vite e mbajti kryetari i saj, Zef Bari.

Pas diskutimeve dhe vendimeve që u morën, u kalua në zgjedhjet e degës.

Kryetar i Degës së Tiranës, u rizgjedh zoti Zef Bari.

Anëtar të kryesisë së degës u zgjedhën 12 vete, kryesisht mbi bazën e shtrirjes së dukagjinave në dy bashki, në bashkinë e Tiranës dhe në bashkinë e Kamzës: Gjon Fierza, Gjergj Shytani, File Moshëqi, Kole Tonaj, Lena Ndervataj, Lazer Stani, Ndoc Fiku, Ndoc Çardaku, Pëllumb Troja, Preke Kosturi, Tome Shpendi dhe Vasel Çuni.

Me datën 25 nëntor 2018, në mjedisin e Bar-Restorant “TRADITA”, u zhvillua Mbledhja e Përgjithshme e anëtarëve të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, dega Shkodër.

Kryetare e Degës së Shoqatës u zgjedh zonjusha Age Martini, N/Kryetar u zgjedh zoti Martin Ahi, Sekretar u zgjedh zoti Martin Arra dhe për ekonominë u zgjedh zoti Gjin Dermani.

Redaksia e gazetës ju uron punë të mbare dhe me faqe të bardhe në realizimin e misionit të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”.

Korrespondenti i gazetës “Dukagjini”



Anëtarët e shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, të degës së Tiranës



Kryetari i degës së Tiranës, Zef Bari dhe anëtarët e kryesisë së degës



Zonjusha Age Martini, kryetarja e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, dega Shkodër



Zoti Martin Ahi, u zgjedh, në detyrën e N/Kryetarit të degës



Zoti Martin Arra, në detyrën e Sekretarit të degës



Zoti Gjin Dermani, në detyrën e kryetarit të seksionit të ekonomisë së degës

Festa Nacionale e Austrisë

Tani u bë traditë, që çdo vit në Shkodër, nën drejtimin zotit Gjergj Leqeza, Konsulli i Nderit të Republikës së Austrisë, të mbledhemi në mjediset e Hotel "Rozafa" dhe të festojmë Festen Kombëtare të Austrisë. Pra, edhe këtë vit, si përhera, me datën 24 tetor 2018, në mjediset e Hotel "ROZAFÄ" u festua Festa Kombëtare e Republikës së Austrisë. Ceremonia u organizua nga Konsulli i Nderit në Shkodër, i Republikës së Austrisë, zoti Gjergj Leqeza dhe Ambasadori i Austrisë në Tiranë, Dr. Johann Sattler!. Morën pjesë deputet, përfaqësues të autoriteteve vendore të Bashkisë Shkodër, të Qarkut Shkodër, personalitete në fusha të ndryshme të jetës shoqërore e sociale të bashkisë tonë. Morën pjesë dhe përfaqësues të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Ndue Sanaj, Luigj Shyti, Syka Çarku e Pal Lera. Pasi, u ekzekutuan Himni i Republikës së Austrisë dhe i Republikës së Shqipërisë, fjalën e rastit e mbajti, Konsulli i Nderit, Gjergj Leqeza. Pastaj të pranishmit i përshendeti Ambasadori i Republikës së Austrisë, në Tiranë, zoti Johann Sattler, i cili në mes të tjerave nderoi me titullin "Certifikata Mirënjohje", me motivacion: "Për kontribut të shquar nder vite në krijimin e lidhjeve ndërmjet republikës së Austrisë dhe republikës së Shqipërisë", zotërite: Prof. Dr. Gjovalin Kolombin, Myzafer Vorfen dhe Gjergj Denellin.

Në fund të përshendetjeve u dha një koketejl për pjesëmarrësit dhe vijoi festa në grupe-grupe.

Fjala e rastit e zoti Gjergj Leqeza, Konsulli i Nderit i republikës së Austrisë, në qytetin e Shkodrës

Të nderuar përfaqësues të komuniteteve fetare!

Të nderuar drejtues të pushtetit vendor!

Të nderuar Deputete të Kuvendit të Shqipërisë!

I nderuar shkëlqesi, zoti Ambasador i Republikës së Austrisë, Dr. Johann Sattler!

Të nderuar miq!

Dëshiroj t'ju falënderoj për zemërsisht të gjithëve ju, për pjesëmarrjen në Festen Kombëtare të Republikës së Austrisë. .

Festa e sivjetshme për të cilën jemi mbledhur asht në përmbyllje të Vitit kulturor Austri-Shqipëri, që me moton "Rizbulimi i të përbashkëtave" në të gjithë territorin e vendit, e jo vetëm, u zhvilluan veprimtari në fushat e historisë, letërsisë, arteve të bukura, filmit, shkencës e dialogut ndërkulturor, i cili u shoqërua dhe me një botim special dhe të cilin shume prej jush kane pasur rastin dhe ta lexojnë.

Të nderuar miq!

Jemi mbledhë sot mbas një sere veprimtarish të zhvilluara me shumë sukses nga Ambasada Austriake në të gjithë territorin e vendit dhe që natyrshëm një numër i konsiderueshëm jo vetëm për nga sasia, por sidomos nga cilësia janë zhvilluar e do të vijojnë të zhvillohen në Veriun e Shqipërisë, me kryeqendër qytetin e Shkodrës.

Viti kulturor filloi me koncertin e Vitit të Ri, me 30 instrumentiste të Filarmonisë së Vjenës, vijoje me operën "Lakuriqi i Natës" të J. Shtraus...e të tjera. Në Shkodër filloi me prezantimin e monografisë "Shkenca në fushën e tensionuar

mes politikes dhe ushtrisë", të Kurt Gostentschnigg, filmin dokumentar "Roli dhe ndikimi i kulturës Austriake në krijimin e elitës shqiptare, në Shkodër gjate themelimit të shtetit Shqiptar në 1912", koncerte të grupeve muzikore, ekspozite

fotografike; "Flashback. Albania in 90s" të fotografit e albanologut Robert Pichler, prezantimi i librit "Marinus Barletius; De Obsodine Scodrensi. Uber die Berlagerung von Skutari", koncertin me rastin e Festes së Pashkëve nën drejtimin e maestro Zhani Ciko, shfaqjen e dramës "Reigen", të shkrimtarit të njohur Arthur Schnitzler, në Teatrin "Migjeni", që vijoi sot para kësaj pritjeje me veprimtari "Lexim letrar me shkrimtarin Austriak Erwin Einzinger" në bibliotekën Austriake të Universitetit Shkodër, "Bisede mbi Franz Baron Nopcsa", me Zj. Adelheid Wolf e ambientin e Qendrës kulturore Arka e që do të mbyllet me një konferencë shkencore në ambientet e Universitetit të Shkodrës mbi përkthimin e botimit të prof. Dr. Marino San Nicola "Administrimi i Shqipërisë përmes trupave Austro-hungareze në dy vitet e pushtimit të vendit përmes urdhërësive të kohës", e cila do të shoqërohet me një ekspozitë të materialeve fotografike shume interesante të asaj kohe ..

Kjo liste e gjate aktivitetesh, kryesisht në Shkodër tregon për rendësin, që Shteti Austriak, nëpërmjet Ambasadës e personalisht mikut special të Shqipërisë e Shqiptareve. Ambasadorit Z. Johann Sattler i kushton prezencës e marrëdhënies të gjithanshme kulturore, historike, shkencore, ekonomike e shpirtërore me qytetin tone.

E gjithë kjo, sepse shume figura e persona nga kjo zone kane gene e janë ngushtësisht të lidhur me kulturën Austriake dhe sistematikisht kane shërbyer si ura lidhëse ndërmjet dy kulturave, vendeve e popujve .

Disa nga këto kemi fatin ti kemi sonte mes nesh e për kontributin e tyre Ambasada e Republikës së Austrisë, e personalisht zoti Ambasador ka menduar ti vlerësojë me titullin "Certifikata Mirënjohje", zotin...

Pra siç dhe e thashë ato lidhje shpirtërore, historike, kulturore, politike po marrin dimensione të tjera, po zhvillohen e forcohen dita-ditës dhe një tregues konkret është dhe pjesëmarrja e përvitshme juaja, për të cilën edhe një here ju falënderoj në emër të Konsullatës së Nderit, në emër të Ambasadës dhe timin personal!

Ju uroj çdo të mire për ju dhe familjet tuaja!

Edhe një here gëzuar Festen e Austrisë! Faleminderit!

Korespondenti i gazetës "Dukagjini"



Ambasadori i republikës së Austrisë, në Tiranë, Dr. Johann Sattler dhe Konsulli i Nderit i republikës së Austrisë, në Shkodër, z. Gjergj Leqeza



Zotëri Myzafer Vorfa, Gjergj Denelli dhe prof. Dr. Gjovalin Kolombi, të cilët u nderuan me "Certifikatën Mirënjohje", nga Ambasadori i republikës së Austrisë, dr. Johann Sattler dhe Konsulli i Nderit të republikës së Austrisë në Shkodër, Gjergj Leqeza

Papa Françesku pret delegacionin shqiptar, vlerëson Skënderbeun

Në pritjen e pelegrinëve shqiptarë të mbërritur në Vatikan për 550-vjetorin e Skënderbeut, Papa Françesku ka përkujtuar me superlativa heroin kombëtar shqiptar, duke e cilësuar hero të vlerave shpirtërore dhe shpëtimtar të krishtërim-it.

Shqipëria, një tokë antike dhe me një histori të lavdishme, është pjesë integrale e Europës dhe përmes traditave të saj më fisnike dokumenton origjinën e qytetërimit të saj. Me këto fjalë ati i shenjtë Papa Françesku ka përshëndetur delegacionin e pelegrinëve të mbërritur në Romë nga Shqipëria, me rastin e 550-vjetorit të vdekjes së heroit kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu.

“Sot përkujtojmë heroin Gjergj Kastrioti Skënderbeu, bir i një populli të fortë dhe bujar që ka mbrojtur me kurajë vlerat shpirtërore dhe krishtërimin, deri në atë pikë sa meritoi titullin Athleta Kristi”, ka deklaruar Papa.

Ati i shenjtë ka vlerësuar se, me gjestet e tij Skënderbeu i dha jetë identitetit kulturor shqiptar, duke u kthyer në një simbol të padiskutueshëm kohezioni dhe uniteti kombëtar.

“Ai ishte gjithashtu personi që ktheu në fakte vlerat e besnikërisë, duke çuar deri në fund zotimet e marra përsipër”, ka vijuar Papa Françesku.

Gjatë takimit, kreu i Kishës Katolike ka kujtuar para të pranishëmve faktin se gjatë epokës së Perandorisë Otomane, Skënderbeu ka patur marrëdhënie me 5 papa: Eugjenin e Katërt, Nikolonë e Pestë, Kaliston e Tretë, Pion e Dytë dhe Palin e Dytë. Dëshmi e kësaj është se edhe në ditët e sotme, në një pallat pranë selisë presidenciale të Italisë ndodhet një afresk që portretizon heroin shqiptar.

“Pak herë në histori një individ i vetëm ka mishëruar në mënyrë kaq të qartë dhe në masë kaq të madhe virtytet e një populli, deri në atë pikë sa është e vështirë të kuptosh shpirtin e tij pa u fokusuar tek parimet dhe vlerat që mishëruan këtë personazh unik”, ka thënë Papa. Pritja e Papa Françeskut ka qenë në kuadër të koncertit të organizuar nga ambasada shqiptare në Vatikan, me rastin e vitit ndërkombëtar të Skënderbeut.

Fjala e Papa Françeskut:

Të dashur vëllezër ipeshkvij e meshtarë, vëllezër e motra,

me kënaqësi të veçantë, ju uroj mirëseardhjen juve, që keni ardhur këtu me rastin e 550-vjetorit të vdekjes së heroit tuaj kombëtar, Gjergj Kastriotit Skënderbeut. Përshëndes me mirënjohje të pranishmit dhe, me mendje, edhe gjithë shqiptarët, në atdhe e në vende të tjera të botës, të cilët, në emër të lidhjeve të lashta të miqësisë e të marrëdhënieve të vazhdueshme, e shohin gjithnjë me dashuri Selinë e Shën Pjetrit. Në këtë kuadër, më pëlqen të kujtoj se 50 vjet më parë, Shën Pali VI deshi të presë një përfaqësi të shqiptarëve.



Papa Françesku dhe delegacioni shqiptar

Shqipëria, tokë me histori të lashtë e të lavdishme, është pjesë përbërëse e Evropës dhe përmes traditave të saj më fisnike e më jetësore dokumenton zanafillën e vetë qytetërimit të saj. Sot, kujtojmë e kremtojmë Gjergj Kastriotin Skënderbeu, bir heroik i një populli të fortë e bujar, që mbrojt me guxim vlerat shpirtërore dhe emrin e krishterë, aq sa të meritonte titullin “Athleta Christi”. Me veprat e tij, farkëtoi identitetin kulturor shqiptar, duke u bërë simbol i padiskutueshëm lidhjeje dhe bashkimi kombëtar, si edhe interpretues në nivelin më të lartë i vlerave të besnikërisë së ndershme ndaj impenjimeve të ndërmarra lirisht.

Rëndësia e veçantë e figurës dhe e veprës së Kastriotit përfaqësohet mirë në flamurin tuaj, me shqiponjën e zezë dykrënore në sfodin e kuq, bërë sipas stemës së heroit. Pak herë në histori, një individ i vetëm ka arritur t’i mishërojë kaq qartë e kaq gjerësisht virtytet e një populli, deri në atë pikë sa është e vështirë t’i kuptohet shpirti, pa u ndalur e pa marrë parasysh parimet dhe vlerat, që e frymëzuan atë personazh të veçantë.

Pas vdekjes së heroit dhe pas pushtimit të Shqipërisë, shumë shqiptarë preferuan të emigrojnë dhe shumë prej tyre u vendosën në Itali, në qendër të gadishullit e në jug, sidomos në Kalabri e Sicili, duke u dhënë jetë Rretheve kishtarë shqiptarë të Ungërës, të Horës së Arbëreshëve dhe të Grotaferratës.

Prania, në takimin e sotëm, të një grupi arbëreshësh, pra, italo-shqiptarësh, me traditat dhe shprehjet e tyre gjuhësore përçarur prej shekujsh, na bën të imagjinojmë atmosferën e Shqipërisë së Skënderbeut dhe na konfirmon se heroit kombëtar mbetet urë e vlefshme për ruajtjen e lidhjeve të frytshme të arbëreshëve me tokën e tyre të origjinës.



Për arsye të rëndësishme të veçantë të figurës dhe të veprës së gjithanshme të Gjergj Kastriotit Skënderbeut, kuptohet më së miri pse Shqipëria ka dashur ta shpallë këtë vit, “Vit mbarëkombëtar të Skënderbeut”.

Uroj me gjithë zemër që ky përvjetor të mos kufizohet në kremtimin e lavdisë së veprave të kaluara, por të jetë për Shqipërinë edhe rast i volitshëm për impenjimin e risuar të të gjithëve – institucione e qytetarë – në favor të një zhvillimi të vërtetë e të ekuilibruar, në mënyrë që brezat e rinj të mos detyrohen të zgjedhin emigracionin, duke e dobësuar vendin nga forcat dhe aftësitë e domosdoshme për zhvillimin e tij njerëzor e civil.

Puna e përbashkët e të gjithëve drejt këtij objekti do të bëhet mënyra më e mirë për të mishëruar në kohën e tanishme, dashurinë për atdheun, që frymëzoi Gjergj Kastriotin Skënderbeu, në kohën e vet. Ai, duke interpretuar sa më mirë karakterin dhe traditat e popullit tuaj, shprehu vlefshëm shqiptarinë, term i përdorur nga shkrimtari i shekullit XIX, Pashko Vasa, për të treguar identitetin shpirtëror, që i bashkonte të gjithë shqiptarët, përtej dallimeve me natyrë fetare. Në Shqipëri, kjo bindje i dha shtysë bashkëjetesës paqësore ndërmjet njerëzve, që u përkasin feve të ndryshme, duke u kthyer

me kohë në bashkëpunim e vëllazërim.

Siç pata rastin të pohoj, me rastin e vizitës sime në Shqipëri, “klime e respektit dhe e besimit të ndërsjellë ndërmjet katolikëve, ortodoksëve e myslimanëve është pasuri e çmueshme për vendin” (Takimi me autoritetet, 21 shtator 2014: Insegnamenti II, 2 [2014], 271). Ajo tregon se bashkëjetesa paqësore ndërmjet njerëzve, që u përkasin feve të ndryshme, është rrugë, e cila mund të përshkohet konkretisht, sjell harmoni dhe çliron forcat më të mira e krijimtarinë e mbarë popullit, duke e shndërruar bashkëjetesën e thjeshtë në bashkëpunim e vëllazërim të vërtetë. Gatishmëria për t’i konsideruar ndryshimet si rast për dialog, vlerësim e njohje të ndërsjellë, favorizon gjithashtu, zhvillimin e udhëve shpirtërore të vërteta e bëhet shembull i vlefshëm, për t’u parë me interes të madh në ndërtimin e një paqeje të qëndrueshme, themeluar mbi respektimin e dinjitetit të njeriut.

Duke përkujtuar me mirënjohje shenjtoret martirë, që e dëshmuar fenë me çmimin e jetës, si edhe shën Terezën e Kalkutës, me kënaqësi, i jap Bekimin Apostolik secilit prej jush, këtu të pranishëm, familjarëve tuaj dhe gjithë popullit shqiptar. Një favor, mos harroni të luteni për mua. Faleminderit.

DOM LAZER SHELDIA MËDEL BASHKIMI, VLLAZNIMI E MIRËKUPTIMI

Dom Lazër Sheldia kishte një ëndërr të madhe për t'i bashkuar të gjithë shqiptarët rreth shtëpisë së Zotit. Ai ishte një mikpritës dhe bujar shembullor. Çdo emigrant që ka shkuar për të kërkuar ndihmë tek ai, i ndihmonte pavarësisht besimit fetar që ata kishin, mjafton që ata të ishin shqiptar, sepse e kuptonte shumë mirë se rruga dhe mundimet e emigrantëve nuk kanë të sosur, Dom Pjetër Popaj; famullitari i Kishës Katolike "Zoja e Shkodrës" në New York meshtar dhe aktivist i përkushtuar.

Malësorët e Malësisë së Madhe me malësorët e Dukagjinit prej kah rridhte Dom Lazri, më parë se lufta e mërgimi, i bashkoi mesha e meshtari dhe ma parë se mesha e meshtari i bashkoi gjuha që u pranoi në buzë dhe gjaku shqiptar që u rridh në deje, bashkë me vendosmërinë me ruajte, me mbajte dhe me mbrojte gjuhën dhe traditat, fenë dhe zakonet e të parëve.

Zef Pashko Deda, veprimtar i shquar i emigracionit shqiptar në SHBA

Dom Lazer Sheldia ka lindur më 15 janar 1928, në fshatin Shëldi, i pari familjes Ndokë Kola ishte nga vllaznia Ulçaj (Ulë Mustafës), shpërngulur prej fshatit Mollë e Shoshit 5 faqe rob (breza) me parë prej të cilit ka mbirë e rritur fisi Markolaj me kujtesë dhe lidhje të pashkëputura organike si gjithë sheldiasit e Shoshit me vllazninë nënë.

Çifti Shuke e Tom Pjetër Toma sollën në jetë tetë fëmijë; Lazrin, (më i madhi), Regjinën, Vasën, Pjetrin, Filipin, Kelin, Zefin dhe Markun.²

Në ballin e oxhakut të familjes Toma ruhet një fotografi e fiksuar në celuloid nga dora e mjeshtrit Marubi që përkon me vitin kur Lazri i vogël le fshatin dhe shkon për studime meshtarë në Shkodër. Djaloshi 8-9 vjec, me sy të shndritshëm, veshur me kostum popullor dhe opinga saffani ka pozuar mes prindërve edhe ata me kostumet tradicionale stolisur me aksesoret më të çmuara sinonim i krahinës së cilës i përkisnin. Poeti dhe famullitari historik i fshatit Shendi Dom Ndre Zadeja, duke parë talentin dhe zellin për të nxënë, Lazrin e vogël e regjistroi në shkollën e fetërve në Shkodër. Jetën studentore si seminarist jezuit e filloi në vitin 1941. I shoqërueshëm, i dalluar mes shokës tërhuqi vëmendjen e mësuesve kërkues dhe autoritar të shkollës së fetërve të cilët e vlerësuan me rezultate shumë të mira. Me mbylljen e seminarit, pas ardhjes në pushtet të komunistëve ateist, detyrohet të regjistrohet në gjimnazin e shtetit, ndonëse me zemër ishte i përkushtuar t'i futej rrugës baritore Dëshira për studime nuk iu vra prandaj mësoi fort dhe u bë mësues. Gjate viteve që punoi si edukator u mundua të përçonte te nxënësit e tij parimet e lirisë

¹ Treguar nga Mark Toma, 70 vjeç, banor i fshatit Sheldi Shkodër vëllai i Dom Lazër Sheldisë (Toma)

² Treguar nga Kel Toma, 78 vjeç, banor i fshatit Sheldi Shkodër vëllai i Dom Lazër Sheldisë (Toma)

së fjalës mendimit ndryshe dhe vlerave universale pozitive të doktrinës kristiane. Këto parime ishin të papajtueshme me ideologjinë sunduese të kohës prandaj bie në sy të forcave të sigurimit të cilat



Dom Lazer Sheldia

e skeduan duke e futur në rreth të kuq si kontingjent i padëshiruar i regjimit. Fillimisht në vitet e para të pas luftës ka punuar mësues në fshatin e lindjes Beltojë, duke qënë se ishte personi më i arsimuar i fshatit iu ngarkua edhe detyra e Sekretarit të Këshillit dhe merrej kryesisht me administrimin e shkresave. Me këmbënguljen e tij u ndërtua njëra nga rrugët kryesore ndërlidhëse të fshatit që mirëfunksionon që atëherë e deri më sot. Nga Sheldia transferohet në Shkrel të Malësisë së Madhe, kohë prej së cilës daton një lahutë të cilën Dom Lazri e bëri me porosi dhe ia dërgoi familjes. E punuar mjeshtrërisht me kokë e brirë dhie ka të stampuar në trup datën 06.12.19483. Nënëlojka kordofone është në gjendje të shkëlqyer dhe ruhet si relike e çmuar e familjes Toma, traditë të cilën e ka ngritur në nivel të lartë Mark Toma, vëllai vogël i dom Lazrit, i njohur si instrumentist virtuoz i çiftelisë dhe sidomos violinës në gjithë zonën e Gurit të Zi. Dom Lazri më pas ka punuar rreth 7 muaj mësues në fshatin Kuje të Planit në Dukagjin dhe prej atje realizoi

³ Arkivi i familjes Mark Toma Sheldi, vizituar me 07. 09. 2018.

aventurën e guximshme të arratisjes, pasi kishte nuhatur rrezikun që e priste nga veprimtaria pedagogjike e papranueshme që demonstronte. Prelë Tomë Shpataj duke kujtuar mësuesin e ti te kahershëm

Kisha e Vjetër e Kujës ku thuhet se janë varrosur disa priftërinj. Pasi e mësoi nga unë vendndodhjen, shkoi dhe bëri eksplorim të hollësishëm. Nuk e harroi asnjëherë ekskursionin që na bëri në Qafën piktoreske të Boshit që gjendet si kurorë e gjelbër mbi Kujën e Planit dhe pse për t'u ngjitur atje duhen rreth dy orë rrugë në këmbë. Në Qafë t' Boshit gjetëm një çoban që po kulloste delet, quhej Zef Lulash Coli, ishte nga Dakajt e Shalës. Mësuesi e pyeti gjerësisht për luginën e Shalës, Qafën e Pejës, të Valbonës, Agrit dhe drejtimin ku kufizohet Thethi me Jugosllavinë. Fjalët e bariu na i ritregoi edhe një herë, ndërkohë që ne i morëm si përforsim i mësimëve gjeografike a nise mësuesi paska qenë duke mëndur diçka tjetër më të thellë. Vetëm 3-4 ditë pas ekskursionit të gëzuar, mësues Lazri, bashkoi të gjithë klasën dhe na njoftoi se dy ditët vijuese do bënim pushim pasi ai do të shkonte në një mbledhje në Breg të Lumit në Shalë. Ky ishte takimi i fundit më mësuesin tonë që më pas u shpall armik. Prelë Tom Shpataj na tregon me detaje se si u arratis Lazer Toma i ndihmuar prej të ndjerit Mëhill Pjetrush Krepi. Ditën që mori rrugën e arratisjes mësuesi i Planit në Qafë të Boshit është takuar me shtetasin Mëhill Pjetrush Krepi, Kryetarë i Këshillit të fshatit⁴. Aty dredhën bashkë nga një cigare dhe në kuvend e sipër Mëhilli e pyeti:- Ku po shkon zoti mësues.- Po shkoj në Breg të Lumit se, kam një mbledhje për çështjen e shkollës.- Po të kishe mbledhje lajmi do të vinte në zyrën e Këshillit më parë se tek ju, ndërkohë që unë nuk di asgjë. Ka disa gjëra që ju nuk i dini more kryetar, por tungjatjeta se po nisem se jam jo pak vonë. Mësuesi mori rrugën drejt Gimajve jo teposhtën drejt Bregut Lumit. -Mësues, ke hy gabim, ajo rrugë nuk të çon atje ku ke mbledhje e këshilloi Mëhilli.

- Në paç besë burri po të them se ka due të shkoj. -Kuptova gjithçka zoti mësues. E di se nuk i ke punët mirë me qeverinë, prandaj ta bëftë Zoti rrugën e mbarë! Vetëm unë e lisat e dëgjuam, se çfarë fole ja preu në mënyrë stoike Mëhilli, i cili duke pas frikë se mos ngatërronte rrugën dhe binte në duar te ruajtësve të kufirit e përcolli dhe i tregoi shtegun e kalimit për në Plavë. Gjithnjë sipas kujtimeve Prelë Tomë Shpatajt që konfirmohet edhe nga 90 vjeçi Mëhill Nikë Ndoka (Rrushaj) mësues Lazer Toma gjatë kohës që shërbeu në Kuje u strehua bujarisht në shtëpinë e Sokol Marashit. Një ditë e zonja e shtëpisë kur i ndërroi çarçafët, poshtë dyshekut i gjeti një libër teologjik të ndaluar që studiohej në shkollën e fetërve. Gruaja i kallëzoi të shoqit i cili i tha,- Hesht, ki kujdes se po t' shket gjuha se pasha Zotin po mori vesh sigurimi e fusin në burg, se ka qenë në shkollë për frat. Ne turpnohemi, se me na u pre miku

⁴ Treguar nga Prel Tomë Shpataj, 80 vjeç, nga fshati Plan, i cili ngjarjen e ritregon sipas bisedës që ka bërë vite me parë me të ndjerin Mëhill Pjetrush Krepi, personi që ndihmoi Lazer Sheldinë të arratisje.

nuk e dum vetën gjallë. Kur erdhi mësuesi pasdite, Sokoli i tha: Gruaja e ka pa një libër kur të ndërroi çarçafët, por mos u ban marak se nuk do ta marrë vesh askush tjetër. Je në shpinë temë e në besë të Zotit e temën.⁵ Në një meshë të zhvilluar nga arqipeshkvi në Kishën e Planit, gjatë shërbesës së lutjeve, mësuesi i lexoi disa pjesë nga ungjilli. Informatorët i shkruan letër Komitetit të Partisë duke shtruar pyetjen;

- Na keni dërguar mësues për nxënës apo prift, pas kësaj ngjarje pozitat e mësues Lazrit rrezikohet së tepërmi, prandaj nuk i mbeti zgjidhje tjetër veç arratisjes. Gjithsesi u largua më shpirt të lënduar prej ciklonit anti Krisht që kishte pushtuar qiellin shqiptar. Fillimisht pas shkapërcimit të kufirit vendoste në në Jugosllavi në një kamp azilantesh politik, ku për 18 muaj u survejua dhe u keqtrajtua, por nuk ia arritën ta rekrutonin në shërbim të UDB-së. Sipas kujtimeve të shokut të tij të vjetër Martin Jaku nga Nënnavriqi i Shalës (beltojas), me të cilin ka qëndruar edhe në Brazil. Dom Lazri kur betohej thoshte;- "Pasha vuajtjet e Jugosllavisë".⁶ Në vitin 1954 arratiset nga kampi në Kroaci, ikën i fshehur në ngarkesën e një kamioni transporti dhe shkon në Vjenë (Austri). Një agjent i sigurimit shqiptar, që ishte deklaruar në Shqipëri si i arratisur ka arritur të infiltrohet në Kampin e azilantëve shqiptarë në Jugosllavi. Agjenti bënte punën e muratorit, i thjeshtë, i komunikueshëm shtirëj shkëlqyeshëm si antikomunist i paparë dhe survejonte të arratisurit se si vinin dhe kush i ndihmonte të arratiseshin nga Shqipëria. Prej Lazer Tomës në mënyrë kofidenciale mësoi se ishte ndihmuar nga njeriu i mirë Mëhill Pjetrush Krepi, për të cilin lutej që Zoti të ia shpërblente me të mira! Agjenti i mirë-stërvitur arriti të mbledhë edhe dëshmi të tjera nga të arratisur të tjerë që kishte ndihmuar Mehil "Zeza", i cili më pas përfundoi në pranga duke vuajtur 6-7 vite burg politik.⁷

Në Austri, para të riut emigrant politik, u hap udha për të vijuar rrugën për të cilën kishte filluar studimet në shkollën jezuite. Shkon në Itali dhe regjistrohet në Universitetin e Urbinos, Propaganda Fide. Jashtëzakonisht studios, arrin të shlyejë provimet e dy viteve brenda një sezoni. Me përfundimin e studimeve, në vitin 1960 shugurohet, meshën e parë ja kushtoi të madhit Zotit dhe Shqipërisë.

⁵ Treguar nga Mark Toma, 70 vjeç, banor i fshatit Sheldi, Shkodër, vëllai më i vogël i Dom Lazër Sheldisë (Toma)

⁶ Treguar nga Mark Toma, 70 vjeç banor i fshatit Sheldi, Shkodër vëllai më i vogël i Dom Lazër Sheldisë (Toma)

⁷ Treguar nga Kolë Nik Thani 25 09 2003 sipas thënieve të djalit të xhaxhait të tij Prekë Tomë Thani emigranti vjetër New Yorku Në kohë të ndryshme ketë gjë e pohojnë në kujtimet e tyre edhe Prel Tomë Shpataj nga Plani dhe Kel Toma nga Beltoja

Duke parë nevojën e emigranteve për meshtarë Selia e Shenjtë e emëron kapelan i shqiptarëve për Europën Perëndimore. Tre vjet më vonë, në vitin 1963 ai dërgohet si misionar i Krishtit në arkidioqezin e Rio De Janerios në Brasil, ku punoi deri në vitin 1973. Në muajin mars të vitit 1973 dom Lazri vjen në Californi (SHBA), ku qëndron 6 muaj



Prindërit, Tome e Shuke Pjeter Toma të Dom Lazerit, Lazeri i vogël

dhe më pas udhëton drejt New Yorkut. Nga viti 1973 deri në 1988, qëndroi në New York, ku për 15 vjet i shërbeu komunitetit amerikan dhe shqiptarë në kishën Holy Rossary, në Eastchester Road, Bronx, New York.

Ka shërbyer gjatë në kishat amerikane kryesisht të komunitetit italian gjithnjë i zënë err e terr me punë meshtarie kreu sakramente shërbimet shumë pastorale të nevojshme për besimtarët amerikan dhe shqiptarë. Gjuhën e konsideronte si ndër të parat shenja dalluese të përparimit të një kombi, prandaj pranë kishës ku shërbeu hapi klasa ku jepte mësimin e gjuhës shqipe për emigrantët shqiptarë Dom Lazri së bashku me mons. dr. Zef Oroshi për vite me radhë u treguan besimtarëve shqiptarë ballafaqë demokracisë më të fuqishme të rruzullimit se vinin nga Shqipëria e mbyllur e shtypur dhunshëm nga komunizmi dhe diktatura e Enver Hoxhës, e cila brutalisht kishte ndaluar ushtrimin e fesë, dhe po masakronte klerin katolik dhe popullin shqiptar, duke e kthyer Shqipërinë në shtetin e vetem ateist në botë.

Studiuesi dhe publicisti Tomë Mrijaj na bën me dije në shkrimet e tij se: Ishte vera e vitit 1973, kur ai zbriti për herë të parë në Californi, i ftuar nga një ish shok i klasës kur ishte me studime në Itali. Sërisht, me avion ai niset për një udhëtim drejt New Yorkut, ku qëndron për disa muaj tek disa miq dhe të njohur të tij në Brooklyn dhe Manhattan. Meqenëse dom Lazri

kishte ardhur për vizitë turistike, vendos të jetojë në SHBA, nga dëshira e madhe për të qëndruar pranë bashkëkombasve të vet, mbasi në Brazil nuk kishte pasur fatin të njihet me shqiptarë. Mbasi i rregullon dokumentet e nevojshme të rezidencës, ai stabilizohet (vendoset) në fillim në Brooklyn pastaj në Bronx, NY, ku fillon të shërbyei bashkësisë katolik shqiptar në New York, në kishën amerikane Holy Rossary në Eastchester Road, Bronx, NY. Ai u interesua për formimin e Qendrës së Dytë Katolike Shqiptare Shën Pali e Shën Pjetri, gjë që e vazhdoi deri sa humbi jeten tragjiksht 8. Një ditë të diel si zakonisht në orën 14-30 besimtarët prisnin ardhjen e fratit për dhënie e meshës, mirëpo kaluan një orë e dy dhe Dom Lazër Sheldia nuk mbërriti. Nuk vonoi, më 22 nëntor të vitit 1988, u dha lajmi nga policia e shtetit të New Yorkut. (NYPD) u gjend i vdekur në strehën e tij. me një gozhdë të ngulur në kokë. Nga publicistët shqiptaro-amerikan kjo vrasje është krahasuar me ngjarjet tragjike të kohërave Herodotit, Pompeut dhe Augustit. Sipas të afërmeve të informuar nga emigrantët tanë në New York, trupi i pajetë i Dom Lazrit është gjetur tre ditë pas vrasjes. Enigmatike tmerrësisht e dhimbshme dhe shumë e papritur që vdekja e misionarit të Zotit. Kisha katolike shqiptare e New Yorkut humbi tragjiksht shërbëtorin e Zotit e t' Atdheut, predikuesin e fesë dhe të moralit, frymëzuesin e dashurisë, urtisë e vllaznimit shoqëror e kombëtar. Në lidhje me këtë ngjarje Kongresmeni arbëresho – amerikan Joseph Diguardi kërkoi në shtëpinë e Kongresit Amerikan për ngjarjen tragjike të vrasjes kriminale të Dom Lazër Sheldisë. "Ky nuk është një moment i gëzueshëm për komunitetin shqiptar. Seminarët dhe kishat në Shqipëri janë të mbyllura. Klerikët atje po mbyten nga regjimi komunist e tani edhe Dom Lazer Sheldia. Një shpresë shqiptaro- amerikane në këtë vend u gjend i vdekur. Vdekja tragjike e Dom Lazër Sheldisë ka tronditur komunitetin shqiptaro-amerikan⁹.

⁸ Tomë Mrijaj "Monsinjor Dr. Zef Oroshi një jetë e shkrirë për Fe e Atdhe", (Jetëshkrim), New York, 2009, fq. 185

⁹ Tomë Mrijaj "po aty, fq. 190

Veprimtari i mirënjohur shqiptaro-amerikan Zef Pashko Doda në esenë "Dom Lazër Sheldia ndalu pak" me shumë ndjenë elokucencë dhe mjeshtri artistike rreth vdekjes misterioze shkruan: - Zani dhe oshtima e kësaj tragjedie të hatashme u hap si vetëtima, e mu si rriba e veriut, që prej shpellës së katallajve del e jetën e mrrudhë, mrudhi fytyrat, shpirtinat dhe jetën e shqiptarëve kur nga radio, televizioni dhe shtypi amerikan, një fjalë shqiptoi si kushtrim: Tragjedia e Klerit Katolik shqiptar nga dy pjesët e Atdheut të shtypur dhe të robëruar u shtri me hidhërim edhe ma të madh deri në margjinat e botës së lirë. Varroset me nderime dhe respekt nga komuniteti shqiptaro amerikan, në varrezat katolike në Saint' Raymond's Cemetery, Bronx, NY. Shërbesën fetare e drejtoi Im Zot Rrok Mirdita: Në rrasën e varrit të misionarit të Krishtit dom Lazër Sheldia gjendet e shkruar në shqip ky epitaf: "Në Përkujtim të Përvjetshëm të Misionarit Katolik." Pistat e vrasjes janë akoma të pakonfirmuara saktësisht dyshohet se pas ekzekutimit ishte dora e sigurimit shqiptar, madje Gjon Sinishta me bindje të plotë thoshte se e vrau sigurimi. E konfirmuar plotësisht është se atë e vrau një dorë e zezë shqiptare. **Dom Lazri e donte Shqipërinë si djali nënën i dhimbshin shqiptarët dhe bëri shumë punë të mira për të. Ai kishte një zemër të pastër dhe shumë bujare që buronte nga indi i tij shqiptar, shartuar me sythet e një kulture perëndimore dhe morali të qelibartë kristian. I kulturuar më së miri, njohës i disa gjuhëve të huaja serbo-krotisht, latinisht, italisht frëngjisht dhe anglisht, me dije të gjëra në filozofi, teologji kishte një pasion të madh për letërsinë dhe në veçanti për poezinë.**

Miku i tij Tomë Mrijaj në kujtimet e veta thotë se, Dom Lazri shkruante poezi, të cilat kishte dëshirë t'ua lexonte miqve të shumtë që shkonin për ta vizituar në shtëpinë e tij. Vlen të theksohen vjershat kushtuar Nënë Terezës, dëshmorëve të atdheut, natyrës, nënës e shumë dorëshkrime të pa botuara.

Si njeri i kulturuar i donte librat dhe kishte një bibliotekë shumë të pasur. Librin e konsideronte gjithçka buka uji dhe pasuria. Ai me librin në dorë ishte si fëmija i vogël me lojën e parë. Çdo minutë kohës së lirë e shfrytëzonte për të lexuar ndonjë poezi letërsi filozofi madje dhe studime artikuj dhe studime astronomike Dom Pjetër Popaj meshtarë i kishës shqiptare në New York, duke vënë në dukje këtë fakt thekson: **Kur Dom Lazri kaloi në amshim, një ditë famullia ku ai shërbente na telefonoi që të merrnim librat e bibliotekës së tij, të cilat i ruajmë edhe sot në kishën tonë.** Dom Lazër Sheldia me mikun madh të tij, mons dr. Zef Oroshin ishin bashkëthemelues të Qendrës Shqiptare dhe revistës kulturore "Jeta Katolike", e cila botohet në New York prej vitit 1966.

Dom Lazri ëndërroi e punoi gjithë jetën mirësisht duke qenë model shembullor bashkimi, vllaznimi e mirëkuptimi.

Përgatiti Prele Milan

Nëse do të bëhesh i guximshëm ...



Shumë njerëz, në përballje dhe përballime, me jetën dhe të tjerët, ndjehen të humbur. Në përpjekjet e tyre, për të arritur diçka, nuk e arrijnë dot qëllimin. Dështojnë, pësojnë zhgënjime, ndjehen humbës. Disa fajsojnë të tjerët, dikush tjetër rrethanat dhe, ai që është realist, fajson veten.

Njëra, ndër arsyt kryesore që njeriu dështon në qëllimet e veta në jetë, është mungesa e guximit. Që në fëmijërinë e tij të hershme ka mësuar të gabuarën, frikën, në vend të guximit. Nga prindët, gjyshërit dhe të tjerë të rritur, vazhdimisht kanë dëgjuar shprehjen: Kujdes! Avash! Hiqe nga dora, është e rrezikshme! Mos e prek! je i vogël! etj. Nga shprehje të tilla ata kanë mësuar se, pas çdo veprimi që kryejnë, pas çdo gjëje me të cilën merren, fshihet një rrezik. Të tillë, në vend të guximit, edukohen me frikën. Kjo krijon bindjet e gabuara tek ata si: „Unë nuk mundem“. „Unë jam i paaftë“. „Nuk guxoj“. Gjatë gjithë jetës së tyre, ata sundohen nga konceptet e gabuara si: „Unë nuk di gjë“, „Unë nuk jam në rregull“, „Unë jam shumë i mangët“, „Unë nuk bëhem kurrë i sukseshëm“, „Unë jam budalla“, etj. Nëse mendime të tilla përforcohen edhe nga shkolla, atherë njeriu i ka shumë të reduktuara shanset për të përballuar dhe përballur me jetën. Fëmia që vihet nënkontroll me dhunë, e humbet ndjenjën e përkatsisë, mendon se nuk i takon askujt. Tek secili që i krijohet ndjenja e mospërkatsisë, në familje, grupe apo në jetën sociale, zhvillohet ndjenja e inferioritetit. Gjithkush mund t'ia marrë „copën“ nga dora. Nuk guxon sepse, ka mësuar që të mosguxojë. Tek ai zhvillohet ndjenja e frikës, e vetizolimit, agresionit dhe rebelimit. Ai vazhdimisht dëgjon një

zë të brëndshëm që i thotë: „Kujdes!“ Kjo do të thotë se, gjithçka që ai mendon të bëjë, është e rrezikshme, Nuk i beson më vetes, ndjenja e vetëbesimit është shuar.

Si i bëhet, a mund të mësohet përsëri guximi?

Përgjigjia është: Po, guximi mund të mësohet.

Si? Që ta themi shkurt, kjo mësohet kështu: Zgjoju, tregohu aktiv, futu aty ku është frika. Bëje atë që të duket e rëndësishme, zbuloi pikat e tua të forta, tregohu i dashur me vetëveten dhe kërko vendin që të takon. Ky është „programi“ i vetinkurajimit. Nëse ti vetinkurajohesh do ta fitosh guximin, motorrin e jetës.

Guximi është gjeneratori i forcave të tua të brëndshme, për të arritur çdo qëllim. Guximi është produkt i vetëbesimit. Pa vetëbesim, nuk ka guxim. Sa më shumë që njeriu respekton forcat e veta dhe zhvillimin e vet, aq më shumë i rritet besimi në aftësitë e veta (vetëbesimi). Brënda tij zhvillohet dialogu: „Unë do t'ia dal“, „Unë mundem“ ose, „Disi do t'ia bëj“. Është pikërisht e kundërta e asaj që ka dëgjuar kur ishte fëmijë, zërat e dekurajimit që i ka besuar: „Unë nuk mundem“.

Çelësin e vetëbesimit, vetinkurajimin, e ka secili vetë në dorë.

Për rritjen e vetëbesimit, faktori kryesor nuk janë të tjerët por, secili vetë, me besimin në aftësitë dhe mundësitë e veta. Duhet të guxosh të fillosh të provosh.

Vetinkurajimi zgjon një qëndrim të brëndshëm i cili duhet inkurajuar. Zgjon nga dremitja aftësitë individuale të njeriut të cilat, që në fëmijërinë e hershme, dekurajimi i ka kaluar në dremitje. Rritë ndjenjën e vetëvlersimit, dhe përfundimisht çon në idenë se. „E di, jam në rregull. Kështu siç jam, jam i aftë mjetueshëm.“ Dhe, në konkluzionin se: „Unë mundem“.

Asnjë vlerë nuk kanë idetë, planet, pikpamjet, qëllimet, sado të përsosura të jenë ato, nëse mungon guximi. Nëse njeriu mbyllet në bodrumin e dekurajimit, çdo gjë është e pavlerë. Dekurajimi na grabitë në armën më të fuqishme për jetën, guximin. Guximi është krijimtari, gjëja kjo më e rëndësishme për zgjidhjen e problemeve të jetës. Guximi e bën të dobton të fortë, të semurin të shendoshë,

të deshpruarin të sigurtë, frikacakun guximtar, të „voglin“ të madh. Njerëzit guxojnë të ulen në tavolinë përballë njeri-tjetrit dhe i bëjnë diskutimet konstruktive, përmirson paqen dhe harmoninë në jetën bashkëshortore, në familje, në punë dhe kudo, ku njerëzit jetojnë bashkë.

Gjithçka që ne përjetojmë, është rrjedhojë e dekurajimit ose inkurajimit, e frikës apo e guximit.

Ndjenja e fajsisë dhe inferioritetit, kufizojnë aftësinë e vlersimit të mundësive tona dhe ne, nuk bëhemi dot ata që në fakt jemi.

Guximi është vaji i motorrit social. Një shoqëri që përbëhet nga njerëz të demotivuar, të dekurajuar, të dëshpëruar, nuk ka shanse zhvillimi dhe përparimi. Një shoqëri e tillë, as nuk komandohet dhe as nuk drejtohet. Ajo përçahet në grupe, rryma dhe lëvizje të ndryshme. Frikacakët gjithmonë kërkojnë një „çadër mbrojtëse“, të fortin. Mjeti më i sukseshëm për sundimtarët, në jetgjatësinë e tyre në pushtet, është „mbjelja“ frikës tek njerëzit.

Të jeshë guximtar në jetën sociale, ndër të tjera, do të thotë: Të guxosh të thuash mendimin tënd dhe, ta mbrosh atë, në çdo rrethanë dhe, para cilitdo. Edhe nëse të tjerët duan të shikojnë apo dëgjojnë diçka tjetër nga ti. Edhe nëse të kritikojnë.

Guximi është gatishmëria e jote për t'u ballafaquar, në mënyrë aktive, me jetën dhe të tjerët. Edhe nëse problemet janë të vështira, edhe nëse bëhesh i pakëndshëm për të tjerët, edhe nëse rreziku duket aty afër.

Guximi duhet edhe për të pranuar pikat e dobëta dhe gabimet e tua, pa e përçmuar dhe demotivuar veten.

Secili mund dhe duhet ta vendosë vetë nëse, do të afrohet me të tjerët, do të vëndosë kontakte, do të shfaqë interesa apo do të tërhiqet në vetmi, do të kërmillzohet në guackën e vet. Mbyllja në vetëvete dhe pasiviteti janë fundi i së arthmes.

Që të jetosh në jetën sociale dhe të jesh aktiv në shoqëri apo do të vetëizolohesh, këtë e vendosë vetë secili. Ndjenja e frikës dhe e vetëizolimit janë të mësuar dhe si çdo gjë e mësuar, mund të ç'mësohet. Kjo varet nga secili.

Kur flasim për guximin, nuk kemi

parasysh vetëm aktivitetin dhe njerëzit. Fjala është për kontributin në interes të shoqërisë njerëzore. Është fjala për veprimet e secilit në interes të familjes apo grupit ku bën pjesë.

Guximi duhet të mbahet nënkontroll nga llogjika. Llogjika pa guximin, është e mangët. Guximi pa llogjikën, është i verbër. Njeriu sociodestruktiv, i cili injoron moralin, normat dhe ligjin dhe shkatron, ashtu si terroristët, nuk mendohet i guximshëm. Ai është njeri frikacak, fanatik, i dekurjuar, i dëshpëruar, i dështuar i cili mundohet të arrijë diçka, për interesat e veta, në mënyrë të paligjshme ose provon të hakmerret. Frikacakët gjithmonë përmbajnë një potencial të madh rreziku për shoqërinë. Guximtari nuk vret kurrë, frikacak vret. Në natyrën e guximtarit janë, tavolina e bisedimeve, pajtimi dhe falja. Frikacak nuk e njuh as tavolinën e bisedimeve, as faljen as pajtimin. Sepse nuk guxon. Ai të bjen passhpinde.

Guximi i fituar nëpërmjet vetëbesimit është baza për pjesmarrjen aktive në jetën sociale, për të qënë krijues dhe sociokonstruktiv. Kjo mund dhe duhet të mësohet nga secili.

Shumë njerëz vuajnë nga dëshira e madhe e „përkryerjes“. Duan të jenë gjithkund dhe për gjithçka të përkryer. Kjo është një ide e gabuar. „Përkryerja“ është thjeshtë dhe vetëm një iluzion. Askush nuk është dhe as nuk mund të bëhet i përkryer. Tipa të tillë janë të demshëm për veten e tyre dhe të tjerët. Aq më tepër ata që e mendojnë veten të përkryer. Kjo dëmton rëndë kualitetin e jetës, bën që të kesh vazhdimisht frikë nga gabimet e mundshme dhe të heqësh dorë nga shumë dëshira në jetë. Të ngushton sferën e veprimtarisë, për pasojë, atë të guximit. Gabimet janë njerëzore. Vetëm ai që nuk është më aty, nuk gabon. Përse duhet të jem unë i përsosur kur, askush rreth meje nuk është i tillë? Me kë do të mund të jetoj dhe komunikoj unë, kur nuk është askush i tillë? Mundohu të jesh normal dhe jo i përkryer! Aty ku nuk flet guximi, varroset jeta.

Lekë Imeraj
shkrimtar dhe përkthyes

Porosia e fundit: më varrosni pranë babës tem, në Shqipëri!

Ende pa ndërruar jete në një gjendje të rende shëndetësore, në prani të djalit të tij, Mondit i la një amanet: "Më varrosni në Shqipëri, pranë babës temë!" Ishte Pjeter Leke Gjoni nga fshati Ukebibaj, Shllak, i cili vitet e fundit jetonte pranë djalit të tij, në SHBA, New York. Pjeter Leke Gjoni ishte djali i Leke Gjonit, i cili përjetoj një kalvar të madh vuajtjesh gjate gjithë jetës së tij. Në vitin 1946, edhe pse babai i tij ishte kryetar i këshillit, arrestohet e torturohet duke u akuzuar për vrasjen e partizaneve. Asnjë here në jetën e tij nuk e pranoi një gjë të tillë, por pas torturave e dërgojnë përsëri në Shllak, duke e push-

katuar në prezencë të të gjithë banoreve, tek Kroni i Kalbet, në Shllak, duke mos lejuar ta varrosin, për të krijuar panik e terror në popullsi. Pas shume mundimesh, në fshetësi, trupi i tij e varrosin në kishën e Shën Prendes, në Ukebibaj.

Ishte viti 2006 kur eshtrat i transferuan në varrezat katolike Shkodër, duke zhvilluar një ceremoni siç i ka hije një burri të nderuar të malësisë.

Pjetri, gjate gjithë jetës së tij nuk harroi për asnjë çast shtëpinë dhe tokën e tij në Shllak.

Pas një sëmundjeje të gjate ndërroi jete në SHBA, New York, me 31 tetor

2018 dhe u varros në Shkodër, me 3 nëntor 2018, në varrezat katolike, duke përmbushur amanetin e tij.

Ne emër të gazetës "Dukagjini", i shprehim ngushëllime djalit të tij, Mondit, tri vajzave, si dhe të gjithë të afërmeve të familjes të Zojzave.

Përgatiti Zef Nika,
Bruksel



Disa këshilla të dobishme, për të mbrojtur zemren tuaj sipas mjekeve të specialiteteve të ndryshme në nivel botëror. Në ditën botërore të sëmundjeve të ze mrës dhe trurit.

Sëmundjet e zemrës si kudo në bote dhe në vendin tone vrasin më tepër se të gjitha llojet e kancerit (po, sido që është sëmundje e pa shërueshme), po shtohen rastet e infarkteve në moshat e reja dhe tek grat e reja. Sido që me futjen e metodave të reja të fibrinolizes dhe angioplastikes me vendosje të stentit (unazave) vdekjet kane zbritur nga 30-40 % vitet 95', para fibrinolizes në 10 %, me perspektive për të arritur në 1 %.

Disa këshilla që japin specialistet e ndryshëm në bote për të mbrojtur zemrën tuaj:

1 Mund të merrni dhe vezë. Regjimi pa kolesterol nuk ul aq fort nivelin e tij në gjak, dhe Ushqimet që përmbajnë shumë kolesterol kane shpesh veprim antioksidant. Vezët janë shumë të pasura me proteina dhe yndyra esenciale, - *Carolyn D-Mjeke et natyropathe*

2 Flini 8 orë gjumë në nate-. Mungesa e gjumit favorizon hipertencionin dhe pra rrit rrezikun për zemren. Provoni të flini nga ora 22. 00 e darkës, mos shikoni televizion para se të shtrihen për gjumë dhe siguron errësire të plot në dhomën e gjumit. Mos pini kafe pas dite dhe as alkool në darke. - *Jennifer Hyathe-cardiologe-Universiteti -Columbia -New York*

3 Mos përdorni ashensorin-ngjitni shkallët. Ashensori dhe modernizimet e tjera ulin sforcimin fizik të përditshëm, prandaj ecni në këmbë dhe ngjitni shkallët në këmbë, harrojeni ashensorin. *Richard Wright-cardiolog -Californi*

4 Meditoni:-Organizmi i stresuar prodhon katekolamina (hormone që japin një përgjigje të furishme) ose kriza, gjë që mund të provokojë lodhje, tedence ose kriza zemre. Prandaj meditimi për 20 minuta në dite mund të ndihmojë. *Archona Saxena-Crdologe New-Jork*

5 Për të mbetur shumë aktiv-Merruni me sport, ecje me hap të shpejt ose vrapim, që në rini dhe pas 70 vjeç mundohuni të qëndroni aktiv, shëtisni, punoni në kopsht, ecni, notoni e të tjera. Të gjitha ushtrimet fizike ju ndihmojnë që të përfitoni prej tyre. - *Prof Christian Brohet, cardiolog në Belgjikë*

6 E qeshura duhet të zër një vend të rëndësishme në përditshmërinë tuaj ...Humori, gëzimi bën që të relativizohen problemet ditore. E qeshura zgjeron arteriet dhe ul hipertensionin. *Suzanne Steinboun Cardiologe ne New York*

7 Hani fruta të vogla, këto fruta përmbajnë antioksidant natyral dhe vitamina E, në pigmentin që u japin ngjyrën, qofshin të freskëta apo të ngrira-janë të mira për zemrën si: boronica, karota, aroret e të tjera,

8 Përcaktoni (matni) TA-në 2015 është vërtetuar, se renja e TA-sistolik në nivel normal 120\80 mm\Hg. pakëson 25 % nivelin e vdekjeve nga insuficienca (pamjaftueshmëria) e zemrës, nga atakët (krizat) e zemrës dhe nga goditja në tru (strok-pika)-AVC.. Pra, duhet të bëjmë ushtrime dhe të ushqehemi shëndetshëm. *Sipas Cora E.Lewis -Universiteti Alabama.*

9 Duhet të përdorim prodhime qumështi të fermentuara. Agrumet janë të pasura me flavanoide dhe vitamina C, është mire të përdoret kos, yagourti, cilli është burim i shkëlqyeshëm i Kalciumit. Duket, se ka lidhje midis shëndetit të zemrës dhe

enëve të gjakut dhe probiotikeve, që janë të mjaftueshme në produktet e fermentuara të qumështit. - *Prof. Jean Michel-Institut Pasteur Lille*

10 Duhet të vaksinoheni kundër gripit stinor çdo vit. Vaksina e gripit është jashtëzakonisht e rëndësishme të behet sidomos për personat që vuajnë nga zemra dhe së fundi është vërtetuar se mbron nga arithmit e zemrës si-Fibrilacioni atrial. - *Jason Guehard-kardiolog Birmingham -Alabama*

11 Kujdesi për dhembët-Higjiena e mire e gojës lehtëson përkohësisht inflamacionin e përgjithshëm (sistematik)-nuk dihet akoma se në c, mënyrë pakëson krizat e zemrës dhe atakun cerebral (AVC); gjë që ka debate prej dekadash, por ajo që dihet vërtet është se një gojë e shëndoshë përmirëson cilësinë e jetës. - *Juli Clary-cadiologe -Universiteti Indiana*

12 Mos merrni shumë kripe gjelle.(NaCl). Sido që debatohet prej kohesh për kripën e gjellës-si person them, të mos përdoret kripore në tavolinën e ngrënies-shtoni erëza si rozmarine, majdanoz, mendër basilicacurcuma e të tjera dhe të kënaqeni. Mos kaloni 5-6 gr kripë gjelle në ditë. - *Prof. Clair Mounier-Inst. Cardio-pulmonar Lilli, President i Federatës Franceze të Cardiologjis*

13 Bëjeni në rregull ecjen në këmbë (pra lëvizni). Unë e kam larg stacionin nga zyra mbi 1. 5 km dhe unë eci gjithnjë në këmbë, dhe po të vinë me makine parkojeni larg, që të ecni në këmbë ndonjë km, po ashtu mos merrni ashensor vetëm ngjituni për shkalle dhe kur të flitni në telefon ngrihuni në këmbë dhe në mbledhje qëndroni në këmbë. Bëni 30 minuta aktivitet fizik, ëe paktën 5 dite jave pa llogaritur këto lëvizjet që bëhen të zakonshme. - *Prof. Francois Carre-Kardiolog Rennes-Universiteti CHU*

14 Mos hezitoni të hani peshk-sardele. Hani 1-2 here në javë peshk të pasur me OMEGA-3 si sardele, ton, levrek i egër e të tjera. Kjo është e nevojshme për shëndetin e zemrës dhe të enëve të gjakut. - *Prof. Jean Michel-Lille-France*

15 Duhet të ndiqet sheqeri në gjak (glycemia) -Sëmundjet e zemrës dhe atakët (goditjet) e trurit (AVC) janë shkaku më i shpeshte tek të sëmuret e rritur diabetike. Shëndoshja, përdorimi i pijeve të ëmbla të gazuara ose i çdo ëmbëlsire mund të rriti sheqerin në gjak (glicerine) dhe krijojnë insullino-rezistence (duke bere që të mos veprojnë insulin). Pra të dy janë faktor pararendës (paralajmërues) të diabetit. - *Richard Wright*

16 Beni seanca intensive Aerobie. Ushtrimet aerobike janë të mira për zemrën, ulin TA (Tensionin e larte), pakësojnë trigliceridet e këqija dhe rrisin kolesterolin e mire (HDL-K). Pra, ushtrime dhe ecje çdo dite me rritem për 30-45 minuta, 5 dite në jave, duke mos e harruar asnjë dite ecje të shkurtra dhe lëvizje. - *Paul. B. Longvin - anesteziat Philadelphia -Pensilvani*

17 Kaloni kohën në ajër të pastër-Ndërgjegjësojuni se shëtitja, shkuarja në teatër, në një ose shfaqje show-ose pamja

e një filmi-; lehtësojnë ngarkesën e trurit dhe ul stresin dhe po ashtu shëtitja në diell krijon rezerva të vitaminës D. - *Menyo De -Internist në Los Angeles-Kaliforni.*

18 Menaxhoni stresin tuaj- Stresi është i njohur si një faktor rreziku për zemrën- Sporti.yoga, pauzat e meditimit në



punë, muzika, kafshët shtëpiake shoqërues ose shënimet në bllok e të tjera, secili në mënyrën e vet heq tensionin dhe relaksohet. Po ashtu dëgjoni muzikë. - *Dr. Raymond Kalenbogen-klinika e readaptimit Chu -Saint, -Pierre-Brukselle*

19 Bëni një angiografi-Një Tomodensitometri e zemrës lejon që të zbulohen vuajtjet e hershme të një sëmundje të zemrës dhe sot ky është bërë një ekzaminim i rutinës për të zbuluar shenjat e para të sëmundjeve të zemrës dhe po ashtu me kosto jo aq të shtrenjtë. - *Jasson Guicara*

20 Merrni vitamina K-2 -Studimet më të fundit kane treguar se vitamina K-2 është kryesore përshëndetin e zemrës. Ajo transporton kalciumin në kocka dhe nuk lejon të vendoset në enët e gjakut dhe mund të pastroje murin e enëve të gjakut.- *Adam Splover*

21 Mos neglizhoni sexin-si gjithë ushtrimet e tjera kalitëse funksionon dhe është shkëlqyer për muskulin e zemrës për të dy sexet dhe shpesh është e favorshme duke ndihmuar zemrën. - *Richard Wright*

22 Mos u mashtroni nga ëmbëlsirat (sheqeri)- Në kuzhinë duhet kujdes-duhet përdorur ushqim i ndryshëm -me pak brumëra, me fruta, zarzavate (perime) të stinës të freskëta, por dhe të frigoriferit-eliminoni pjatat me shumë kripe, me pastërma-ulni yndyrat shtazore-merrni vaj ulliri-pra vendosni barrierë për yndyrat e ngopura-sepse janë të dëmshme për zemrën dhe enët e gjakut, por mos harroni dhe sheqeri është i rrezikshëm për enët e gjakut. - *Prof. Christian Brohet-Cardiolog në Belgjikë (Louvain).*

23 Kufizoni alkoolin.-Një përdorim i moderuar i alkoolit 1-2 masa (40 ml), ose 1-2 gota vere (250 ml) mund të ketë efekt pozitiv duke kontribuar për parandalimin e sëmundjeve të zemrës(ne verat e stazhinuara në ene druri dhe alkoolit e rrushit përmbajnë resveratrol dhe sasi të madhe nitroksidi NO-me efekt vazodilatator). Por përdorimi i dozave të mëdha të alkoolit rrezikon për goditje në tru-stroks (AVC). - *Dr. Samuel Molley-Linja Angleze*

24 Sado që te jeni i zënë bëni të pak-

tën tre here në jave lëvizje qoftë në palestër apo në shtëpi për 45 minuta, gjë që ndihmon për shëndetin. Llogaritni të ecni në këmbë, me biçikletë ose një aktivitet sportive. - *Dr.Francois Carre -Reinne.*

25 Pini shumë ujë -Pini të paktën 6-8 gota (225 ml) ujë, që do të thotë 1.5 -2 litra në 24 veç lëngjeve të tjera që merrni me ushqime, gjë që diluon lëngjet e organizmit e redukton rrezikun për sëmundje të zemrës, sepse dehidratimi rrit hematokritin, dmth volumin që zëne rruazat e kuqe. Pra, e bën gjakun më viskoz faktor, që favorizon atakun e zemrës dhe goditjen në tru (AVC), stroka. - *Jasson Guichard*

26 Vlerësoni gjumin-Bllokimi gjate gjumit frymëmarrjes e ashtuquajtura "apnea e gjumit", është një ndërprerje e marrjes fryme për disa sekonda, që privon organizmin nga oksigjeni (O2) si zemrën, trurin dhe indet e tjera, gjë që ka pasoja. - *Adam splaver*

27 Vlerësoni marrjen e vitaminës D. Ka një lidhje midis mungesës së vitaminës D dhe vdekjeve nga zemra (infarcti i comment dhe goditjes në tru (AVC) dhe po ashtu mungesa e vitaminës D është e me HTA dhe hyperglycimine të dy faktor rreziku për zemrën. Pra duhet të matet niveli i Vitamina D dhe duhet të merren shtesa të saj së bashku me kalcium në dozat e nevojshme. - *Nitin Kumar*

28 Dieta vegjetar janë-vitet e fundit ekipet e kardiologëve kane vendosur një program të OMS (OBSh) readaptimin intensive për të sëmuret me zemër, me që ka pasur një rezultat të pa pare (spektakular) mjeket kane vendosur ta zbatojnë. Pra, aspekti qëndron në dietën vegjetarianë 3 mujore dhe provat janë të kënaqshme duke u ndjere më pak të fryra dhe më aktiv pas ngrënies. - *Joseph A.craf -kardiolog.-M saint Luis*

29 Merrni Magnez -Mg., se ndihmon për të mos u rritur kolesteroli-merrni pluhur Mg. Citrat me ujë ose dhe tableta me vitamina B6 gjate ditës. - *Carolyn Dean*

30 Favorizoni mirënjohjen, një studim ka vlerësuar se subjektet që provojnë një mirënjohje të thellë dhe kane kënaqësi në jete janë më pak të prekur nga sëmundjet e zemrës. Pra, miqësia dhe qenia i lumtur zgjat jetën dhe ul rrezikun për kriza zemre dhe goditje në tru.

31 Mos hani asgjë të bardhë- "miell të bardhe, as sheqer, as oriz të bardhe" - *Adam Splaver*

32 Hani çokollate të zezë. Një studim kryer në 2016 tregoi se një sasi jo e madhe ditore e çokolade së zezë parandalon diabetin e sheqerit (D. M). Po ashtu bën arteret më elastike dhe ul TA (tensionin e larte)-përdorni 30-60 gr. Çokollate në dite.

Burimi: - "Selection reader, s' Digest"- Juin-2018 - Përmbledhur nga Cynthia Geyer-Drejtore Mjekësore -Massachusetts - USA

Përkthyer dhe përshtati në Shqip, për botim - Dr. MED. Ndue Nikaj

Kongresi i Manastirit dhe shqipja letrare (110-vjetori i Kongresit të Manastirit)

Në vitin jubilar të 110-vjetorit të lindjes të shkencëtarit e të gjuhëtarit të madh Prof. Eqrem Çabej, është edhe ngjarja e madhe dhe e shënuar në historinë e kulturës shqiptare e Kongresit të Manastirit, hartimi dhe përgatitja e një alfabeti me të cilin do të shkruhej gjuha shqipe.

Ishte një nga detyrat e mëdha dhe të vështira e gjuhëtarëve, e shkrimtarëve dhe në përgjithësi e të gjithë intelektualëve eruditë shqiptarë në dheun amë apo të huaj për të pasur një alfabet të tyre dhe me kahje të hapur për të shkruar e botuar shqipën me lehtësi e ku të pasqyrohej e gjithë dinamika e saj në rrymë të viteve.

Formula e pagëzimit e Pal Ëngjëlilit apo "Meshari" i Gjon Buzukut ishin një shtrat i mirë dhe bazal për t'u orientuar dhe për të kuptuar më mirë se në cilin alfabet duhej të shkruhej gjuha shqipe, se si dhe sa ai do t'i vinte në ndihmë shqiptarëve në të gjitha drejtimet e zhvillimit të jetës për kohën dhe në vijim të saj për të qenë një shtet modern e ku të botohej e të përhapej në të gjitha viset ku jetonin shqiptarët e më gjerë gjuha shqipe në përgjithësi dhe ajo letrare në veçanti.

Siç dihet, dokumenti i parë i plotë i shkruar në rrafshin gjuhësor i gjuhës shqipe është "Meshari" i Gjon Buzukut i vitit 1555, i cili hedh dritë për vlerat e shqipes dhe studimet e kryera rreth tij mbrojnë tezën që shqipja është shkruar shpejt dhe që paraqitet me një strukturë të zhvilluar.

Fjalori i F. Bardhit dhe ato që vijuan më tej, provuan se shqipja, jo vetëm që ishte një gjuhë e zhvilluar, por procesi i saj drejt një shqipeje letrare ishte në rrugën e mbarë. Por frymëmarrjen më të suksesshme drejt një përpunimi me vlera të shënuara njesimi e letrare, gjuha shqipe i mori në vitet e Rilindjes Kombëtare.

Ajo duke qenë një lëvizje me përmasa të gjera shkencore, politike dhe atdhetare, nuk mund të bënte përpara pa vlerësuar në shumanshmërinë e vet gjuhën shqipe në përgjithësi e atë letrare në veçanti, e cila jo vetëm do të unifikonte trevat shqiptare të copëtuara e të fragmentizuara nën pushtimin osman, por do të ishte një shenjë civilizuese e emancipuese për shtetin e ri shqiptar. Në këto vite u hodhën themelet e një shqipeje të njësuar letrare, por që ende paraqitet me dy variante kryesore letrare: atë të toskërishtes letrare dhe atë të gegërishtes letrare. Veprat letrare artistike e gjuhësore të Naim Frashërit, Andon Z. Çajupit, Pashko Vasës, Gjergj Fishtës, Ndre Mjedës, Asdrenit, Fjalori i Kristoforidhit etj., provuan dhe lartësuan vlerat e shqipes letrare, krijuan terrenin e përshtatshëm për shtratin, në të cilën do të ecte shqipja drejt unifikimit të saj të plotë.

Kongresi i Manastirit ishte kurorëzimi i një rruge të vështirë dhe atdhetare të intelektualëve shqiptarë që jetonin në

Stamboll, në Turqi me në krye Sami Frashërin, të cilët në vitin 1879, të caktuar në vitin 1877 nga "Komiteti Stambollit" dhe i përbërë nga personalitete të larta intelektuale të kohës si: Hasan Tahsimi, Pashko

nin e hartimit të alfabetit e gjuhëtarëve të talentuar: Mid'hat Frashëri, Gjergj Fishta, Ndre Mjeda, Bajo Topulli etj., ishte e një rëndësie të madhe, sepse me ndihmesën e tyre në rrafshin e gjuhëve, në filozofinë

europiane, por edhe për të gjetur zgjidhjet më të mira për shqipën e njësuar, për ta ngritur atë me shpejtë në standardet e kohës dhe në një vijë zhvillimi me ato.

Njësimi i gjuhës letrare shqipe i ka themelet në Kongresin e Manastirit, si një tubim me vlera polivalente shkencore, gjuhësore e atdhetare, në gjetjen e një zgjidhje të përbashkët, e cila erdhi nga "Alfabeti i Stambollit", nga rilindësit e mëdhenj Sami Frashëri, Hasan Tahsimi, Jani Vreto, Konstandin Kristoforidhi etj. Ai krijoi një rrugë të re për të gjithë intelektualët që kërkonin zgjidhje për gjuhën shqipe në dritën e ideve të Rilindjes Kombëtare dhe të detyrimeve që kishin intelektualët shqiptarë për fatin e kombit të vet e duke e parë shqipën si mjet kulture, qytetërimi dhe bashkimi kombëtar.

Tubimet që vijuan më tej si: Komisia Letrare e Shkodrës, Kongresi i Lushnjës dhe i Tiranës, botimet e shkrimtarëve të viteve '30, Sesionet Shkencore të vitit 1952, Kongresi i Drejtshkrimit 1972 etj., treguan për vlerat e mëdha e shënues të Kongresit të Manastirit. Vendimet e tij ishin të një rëndësie të madhe dhe me bazament të fortë shkencor gjuhësor.

Shqipja u botua, u shkrua e u përkthye në dhjetra gjuhë të huaja, të cilat dëshmuuan për formimin e lartë shkencor dhe largpamës të rilindësve tanë. Shumë debate akademike në rrafshin e ndryshme të shqipes janë bërë në rrjedhë të viteve, por alfabeti, produkt i Kongresit të Manastirit mbeti i paprekur në parimësinë e vet.

Ai ndihmoi për pasurimin e shqipes në fushat e leksikut, të kristalizimit e të konsolidimit të fonetikës, të morfologjisë e në mënyrë të veçantë në fushën e përkthimeve artistike, pedagogjike, shkencore, në hartimin e fjalorëve dygjuhësh në shkenca të ndryshme etj.

Por asgjë nuk do të arrihet pa rolin vendimtar të shkollës sonë në të gjitha nivelet, pa zbatuar një programacion funksional në të mirë të përvetësimit aktiv dhe të qëndrueshëm të shqipes letrare, pa kërkuar zbatimin me rreptësi shkencore dhe atdhetare të normës së njësuar letrare shqipe, si një vlerë shënues dhe kualifikuese, nga e gjithë shoqëria e sotme, media e shkruar dhe elektronike etj.

Vetëm në këtë mënyrë idetë dhe mesazhet e vendimeve të Kongresit të Manastirit në 110-vjetorin e tij, na i japin të gjithëve për të kuptuar më mirë rrugën e vështirë, dinamikën dhe problematikën e shqipes standarde në rrymë të shekujve e se mesazhi tij mbetet i freskët edhe për kohën që përjetojmë, kur detyrat e mëdha ndaj kombit zgjidhen me urtësi, atdhetarizëm e me profesionalizëm të lartë.

Nga Prof. Valier PESHKËPIA



Vasa, etj. punuan dhe përgatitën atë që u emërtua "Alfabeti i Stambollit", por që veprimtaria praktike e tij ishte vetëm për dy dhjetëvjeçarë dhe nuk arriti të bëhej alfabeti kombëtar i shqipes. Ai në njëfarë mënyre u vu në shërbim të asaj që u vendos në Kongresin e Manastirit nga figura të tilla si: Mid'hat Frashëri, Gjergj Fishta, Ndre Mjeda, Bajo Topulli etj. Alfabeti i shqipes me 36 shkronja dhe atje ku nuk kishte mundësi me dy shkronja si: dh, sh, th etj., por që nuk pengonin kontekstet e ndryshme të transmetimit të mendimit, të mesazhit të artikuluar etj.

Kongresi i Manastirit i 14 nëntorit të vitit 1908 shënoi një kthesë rrenjësore në zhvillimin e shqipes, në botimet e saj në mënyrë të veçantë pas Shpalljes së Pavarësisë Kombëtare në vitin 1912 në Vlorë.

Hartimi i një alfabeti nga përfaqësues të rrymave dhe të krahinave të ndryshme, debati i lartë shkencor, fryma e bashkëpunimit dhe e respektit të ndërsjellë, bëri që të përgatitej një alfabet i tillë i njësuar me karakter kombëtar që të pëlqej dhe të zbatohet nga të gjithë shqipfolësit në të gjitha trevat apo diasporat shqiptare dhe tashmë shqipja e shkruar kishte alfabetin e vet me drejtim nga Europa dhe ajo do të afirmohej, si të gjitha gjuhët e tjera të familjes indoeuropiane.

Ajo dëshmoi se për çështje madhore të kombit të vet intelektualët shqiptarë mund t'i zgjidhin vetë e pa ndihmën e të huajve. Në këtë hulli ky alfabet gjeti shtrirje dhe përdorim të madh e pa diskutim në ligjërimin e shkruar dhe në botimet në të gjitha trevat e vendit. Pjesëmarrja në komisio-

dhe në dinamikën e gjuhëve të tjera dhe të koncepteve të qarta që ata kishin rreth zhvillimit të gjuhëve europiane e më gjerë, bëri që edhe alfabeti i njësuar të kishte një frymë kombëtare dhe njëkohësisht edhe shkencore, me vështrim në përvetësim të shpejtë nga të gjithë folësit e shqipes. Mjafton të përmendim shkrimet e poetit dhe gjuhëtarit Ndre Mjeda dhe të Bajo Topullit në raport me shkrimet e bashkëkohësve të tjerë në Jug apo në Veri të vendit.

Kongresi i Manastirit, i cili u pasua më tej me tubime të tjera shkencore, ndikoi ndjeshëm në përpunimin e mëtejshëm të varianteve letrare të shqipes, në konsolidimin e tyre, në afrimin e tyre në rrafshet e leksikut, të gramatikës, të fonetikës etj. dhe në parimësinë tyre për ligjërimin e folur e të shkruar.

Alfabeti që doli nga Kongresi i Manastirit krijoi mundësi të mëdha edhe për botimin e teksteve shkollore, në përvetësimin e shpejtë e logjik të gjuhës shqipe, në përkthimet e ndryshme në gjuhët e huaja e nga gjuhët e huaja dhe në tregun shqiptar të librit tashmë vëreje botime të shumta, të cilat ndikuan edhe për një formësim kulturor më të lartë e një afrim me kulturat e vendeve të ndryshme të kontinentit evropian.

Alfabeti me bazë gjuhët latine krijoi mundësi të mëdha edhe për përvetësimin e shpejtë të gjuhëve të huaja europiane, të cilat ishin bazuar kryesisht tek gjuhët neolatine. Përvetësimi i shpejtë dhe i disa gjuhëve të huaja natyrisht që krijonte mundësi të mëdha për intelektualët shqiptarë të depërtonin më shpejtë në kulturën

Pema e dëshirave: shëmbëllyra që na tregon se si i sabotojmë jetët tona



Brenda pak kohe, a iu lodh, u ndal për të pushuar në hijen e një peme, pa e ditur se ishte një pemë magjike, e cila u ka

realizuar menjëherë të gjitha dëshirat e atyre që rrinin afër. Duke u ndier shumë i etur, donte të pinte ujë me akull. Në të njëjtin moment, në dorën e tij u shfaq një gotë uji. Shumë i befasuar, ai shuajti etjen e tij. Pastaj e kuptoi se ishte i uritur dhe, sapo donte diçka për të ngrënë, një pjatë e ushqimit u shfaq para tij. Menjëherë njeriu e kuptoi se po ndodhte diçka, të gjitha dëshirat e tij po plotësoheshin. Pa humbur kohë, ai kërkoi diçka shumë ekstravagante: "Nëse është me të vërtetë, unë dua të kem një shtëpi të këndshme", tha ai me zë të lartë. Sapo mbaroi së foluri, shtëpia u shfaq drejtë para tij. Duke mos besuar ende në këtë fat, njeriu dha një buzëqeshje të madhe dhe vijoi me dëshirat. Këtë herë ai i kërkoi shërbëtorëve të kujdeseshin për shtëpinë e tij të re. Ai gjithashtu donte një grua të bukur, inteligjente dhe të kujdesshme për të ndarë jetën dhe pasurinë e tij. Kur gruaja e ëndrrave të tij u shfaq para tij, ai tha: "Nuk mund të jetë e vërtetë. Unë kurrë nuk kam qenë me kaq fat në jetën time. Këto gjëra nuk më ndodhin mua." Sapo mbaroi të thoshte këto fjalë, gjithçka u zhduk, shtëpia, shërbëtorët, gruaja. Me një sjellje konformiteti, njeriu tha me vete: "Natyrisht, u desh kohë që gjithçka të zhdukej. E dija që diçka ishte

e gabuar, diçka kaq e pabesueshme, se si mund të më kishte ndodhur mua." Kështu ai vijoi rrugën duke menduar për shumë probleme të tij.

Shumë herë në jetën tonë, kalojmë nëpër situata të ngjashme me njeriun e historisë. Gjëra të pabesueshme ndodhin, por për shkak se ne dyshojmë në fatin tonë, në mundësitë tona dhe kemi fare pak ose aspak besim se ne i meritojmë ato meqenëse kemi qënë deri tani në kërkim të tyre. Si rrjedhojë, ata përfundojnë duke u zhdukur, duke na lënë vetëm me mendime negative, me emocione negative dhe më pas me dorëheqjen. Kjo shëmbëllyra na mëson se ne duhet të ndryshojmë mënyrën tonë të menduarit për të ndryshuar jetën tonë, të tashmen tonë dhe rrjedhimisht të ardhmen tonë.

Nëse nuk besojmë se kemi çfarë duhet për të arritur qëllimet tona, ky besim negativ do të aktivizohet brenda nesh dhe do të arrijmë ta shohim atë si një siguri dhe nuk bëjmë më lëvizje të mëtejshme për ta ndryshuar. Kjo është e vërtetë për të gjitha fushat e jetës, dhe kjo na bën dalëngadalë të sabotojmë, duke kompromentuar këndvështrimin për të mirën e jetës tonë dhe po ashtu cilësinë tonë të jetës.

Ne duhet të punojmë për veten tonë

për të njohur veten si të aftë për të fituar, për të pushtuar ëndrrat dhe qëllimet tona. Kjo mund të kërkojë një vizitë në fëmijëri, në marrëdhëniet familjare dhe madje edhe në hapjen e vetes. Gjithashtu mund të kemi nevojë për ndihmën e njerëzve të trajnuar. Dhe, në shumicën e rasteve, për një udhëtim për të dalë jashtë rrethit që jetojmë apo krahinës në të cilën jetojmë. Në rastin tonë, udhëtimi nëpër Dukagjin mund të na çojë në gjurmët historike dhe në do të zakonore që janë ngulitur thellë në mendësinë e çdo dukagjinasi dhe që akoma vijojnë të jenë mbizotëruese. Por aktualisht ne, le të vlerësojmë si të nevojshme të qëndruarit poshtë Pemës së Dëshirave dhe të ëndërrojmë: Dukagjini është emancipuar dhe po rrit standardet bashkohore me dinjitet. Kjo nuk është e lehtë, po rezultatet bëjnë gjithçka të dobishme. Vetëm kur besojmë në veten tonë dhe në të drejtën tonë për sukses dhe lumturi, mund të krijojmë jetën që meritojmë të kemi! Nëse ju pëlqeu ky mësim, ndajeni dhe komentojeni me miqtë dhe të njohurit tuaj!

Përgatiti: Suela Ndoja

KRITERET E REDAKSISË DHE NORMAT PËR PUBLIKIM NË GAZETËN E SHOQATËS "DUKAGJINI"

Artikujt e pranuar fillimisht do të vlerësohen nga redaksia. Vlerësimi nga grupi redaktues është i drejtuar për të konstatuar se propozimet e kontributit janë tematikisht përkatëse për gazetën, në përputhje me kodin dhe linjën e redaksisë dhe jo dukshëm të papërshtatshme nga pikëpamja e një artikulli.

Në rast të refuzimit autori do të informohet menjëherë me e-mail - brenda 48 orëve - nga redaksia dhe vendimi do të jetë i motivuar në mënyrë sintetike.

Në rast të një mendimi pozitiv nga ana e redaksisë, propozimet e kontributit do t'u dërgohet specialistëve jashtë zyrës së redaksisë për vlerësim sipas sistemit të rishikimit të dyanshëm të kolegëve. Nëse mendimi i tyre është i favorshëm, artikulli pranohet për publikim.

Nëse gjykimi është i favorshëm, por sugjerohen rishikime dhe shtesa, sugjerimet do të jenë transmetuar tek autori dhe

artikulli do të pranohet vetëm në serishkohet duke marrë parasysh komente të bëra. Autorit i kërkohet gjithashtu të përshtatë artikullin në standardet e hartimit të treguara mëposhtë. Grupi redaktues do t'i kthejë artikujt tek autorët, që nuk janë përshtatur me rregullat. Në rast të mos përputhjes së autorit, gazeta rezervon të drejtën të refuzojë botimin e artikullit.

Artikujt mund të shkruhen në gjuhën shqipe letrare. Ata duhet të dërgohen në adresat e më poshtme: nduesanaj@yahoo.it, sundoprospe@gmail.com deri me datë 15 të muajit përkatës.

FORMATI I ARTIKULLIT

TITULLI: Titulli i artikullit duhet të jetë i vetëm dhe mbi të gjitha i shkurtër dhe informativ, por domethënës që ka lidhje me brendësinë e artikullit. Gjithashtu duhet të shkruhet me shkronja shtypi

PËRMBAJTJA: Le të kujtojmë, përsa

mund të jetë e dukshme, që në çdo rast teksti i propozuar duhet të shkruhet në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, qëllimi i artikullit dhe përmbajtja e përshkruar duhet të jenë të qarta. Sa më shumë që materialet të dërgohen në tekst të thjeshtë, pa format e të çuditshme dhe më pak gabime aq më i mundur do të bëhet redaktimi përfundimtar.

FORMATI I ARTIKULLIT: Duhet që artikulli të dërgohet në Word.

SHKRIMI: Shkrimi të jetë me hapësira 1 dhe pa hapësira të ndërmjetme

GJATËSIA E ARTIKULLIT: Jo më shumë se sa 1 faqe format A4 dhe ½. Në raste të veçanta në varësi të tematikës, mund të pranohen 2 faqe format por artikujt shumë të gjatë nuk pranohen.

PARAGRAFËT: Materiale duhet të ndahet në paragrafë të numëruar dhe / ose të titulluar me shkrim "Times Neë

Roman", Titujt nuk duhet të ndahen nga linjat e lira nga teksti që i paraprin ose nga ajo që vijon

BIBLIOGRAFIA: Duhet të shënohet bibliografia e rregullt nëse i referoheni si citima utorëve të huaj

KORREKTIMI: Autorëve të artikujve të pranuar për publikim do tu kërkohet që të korrigjojnë artikujt që dërgojnë, të cilat duhet të kthehen brenda pesë ditëve. Nuk lejohet futjen e ndryshimeve thelbësore në artikullin e dërguar më përpara.

TË TJERA: Autori duhet të dërgojë një foto dokumentacioni dhe adresën e kontaktit elektronik

Materiale duhet të shoqërohet me foto të veprimtarisë përkatës. Autori duhet të përzgjedhë 2-3 foto kryesore

Autori mund të dërgojë 1-2 artikuj për numër.

Redaksia e gazetës "Dukagjini"

25 vjetori i revistës "Kuç e Zi", në Bruksel

Shoqata e shkrimtareve shqiptare në Belgjike ka festuar 25 vjetorin e krijimit të revistës kulturore euro-shqiptare "Kuç e Zi". Revista Kuç e Zi u themelua e u botua në muajin tetor të vitit 1993, në Bruksel, që ideatori dhe drejtuesi i kësaj reviste është Lek Pervizi. Ishte kjo reviste, që gjeti pritje dhe u përgëzua si një nismë e rëndësishme kulturore, e para pothuajse në Evropë pas shembjes së diktaturës. Themeluesi i revistës "Kuç e Zi" vinte nga burgjet dhe kampet e internimit, pas 45 vjetësh kaluar nën terrorin e diktaturës komuniste. Në kushte dënimi, atij dhe mijëra shqiptareve të tjerë, viktimat

të pafajshëm, u mohojë e ndalohej çdo ore-vajtje krijimtarie letrare, historike e artistike, si dhe veprimtari të tjera të lira; mohojë fjalë e mendimi. Kështu, Lek Pervizi e ndjeu të çonte në vend amanetin e tyre dhe vendosi të krijojë një medie të shkruar, ashtu siç e ëndërronin ato burra të shquar të kulturës dhe historisë shqiptare, që sistemi komunist i masakroi me dhunë të përgjakur. Kjo reviste, tashme mjaft e njohur për të gjithë emigrantet, ka bërë emër jo vetëm tek emigrantet e njohur në Belgjike, por në gjithë Evropën dhe më gjere, e publikuar çdo muaj në internet.

Në reviste gjen faqe historike, që trajtohet gjerësisht figura e Gjergj Kastriot, krijime letrare dhe veprimtari të shqiptareve në të gjithë botën. Koordinatorja e shoqatës, Shqiponja Duro, në bashkëbisedim me drejtuesin e revistës, ka cilësuar punën kolosale të Lek Pervizit, si



dhe promovimin e dy librave të ri "Gjenerali" dhe "Odiseja e pafajësisë".

Mbi vlerat, punën krijuese dhe ndikimin e madh që ka përcjellë në diasporë, në faqet e revistës "Kuç e Zi", foli profesor Kole Tahiri, i cili e quajti një kolos të madh të kulturës shqiptare mbi punën e pandërprerë për 25 vite, në kërkimin dhe pasqyrimin e botimeve të autoreve më të mirë shqiptare, duke sjell aspekte të panjohura për heroin tone kombëtare, Gjergj Kastriot dhe për Nene Terezën.

Në këtë takim, autorin e ka përgëzuar dhe bashkëvuajtësi i tij, Myrteza Bajraktari, me të cilin u njohën që në vitin 1966, i ardhur nga ish Jugosllavia.

Këtë veprimtari të rëndësishëm e ka përhëndetur dhe ambasadorja shqiptare në Belgjike, zonja Suela Janina, e cila ka vlerësuar punën e madhe në botimin e revistës "Kuç e Zi", duke nxjerr në pah vlerat më të larta të popullit shqiptar të panjohura për bashkësitë e tjera, si dhe grupin drejtues së kësaj reviste të përberë nga 5 kontinente, me personalitete të njohura shqiptare.

Në këtë atmosferë festive ishin të pranishëm shqiptaret me banim në Belgjike, Holandë, Luksemburg e France, si dhe nuk kane munguar urimet nga diaspora shqiptare në Amerike.

Përgatiti për gazetën "Dukagjini",
Zef Nika, në Bruksel

poezi *** poezi *** poezi *** poezi *** poezi*** poezi *** poezi*** poezi *** poezi

poezi nga Lazër Preka

AKTE NJERËZORE

Është e shtrenjtë,
Sa vetë Bota.
Arsyeja njerëzore.

Ani se flasin,
Për mbijetesë . . .
Duan drejtësi!

Testohen çdo herë,
Me gjetur të ndershmin.
Nga mungesa e tij . . .

Merre vesh mirë,
O shekulli modern,
Sa larg të la mosha!

Enden evidente,
Nga i madhi te i vogli
Aktet njerëzore.

ME VRAP SE KOHA PO IK

Me thënë të drejtën dita,
Zgjohet më herët se foshnja.
Më shumë se vetveten,
Adhuroj fëmijët e mi.

Ndërsa qepallat i presin,
Pa u gdhirë ëndërrat.

O njerëz,
Me vrap se koha po ik!

AH, O LEKË!

Ah, o Lekë,
Thërrasin shqiponjat.
Mbi shpatullat e maleve,
Rrokullisen vetëtimat.
Ndonëse në viset e tua,
Theu qafën gjysmëhëna.

Atje,
Duke parë në pasqyrën tënde.
Krenaria shqiptare,
Blatohet në flamur.

Ah, o Lekë.
Tek e shoh ballin e gjërë,
Rrotull bjeshkët ulen në gjunj . . .

Kurse çiftelia,
Ushton kullë më kullë.

**EMRI YT, BOTA
E TË GJALLËVE**

Shpupurishen varret,
Eh ti o Lekë,
Gjithsesi pranë yjeve.

Urtësia e kryetrimt shalohet vetë.
Nënat Dukagjinase
Në çdo zemër e yshtin . . .
Bëmat e lavdisë
Ngjizen valë – valë
Brenda viseve bëhen dëshmi.
Emri yt prin botën e të gjallëve,
Skënderbeut i thuret madhështi.

Gjithsesi nipat më të gjallë janë bërë.
Dukagjinit nder i falin.
Ndër të gjithë shugurohet emri yt i denjë.

KUSHEDI, NGA HOBET E RINISË

Tani që e ndjej
Plogështinë, ndoshta
E di se molisja,
Po vjen valë – valë.

Ani, se më ra për hise . . .
Ushtria e ditëve
Si me komandë.
Mbledh forcat e lëna në librin e kujtesës.

Që nga fëmijëria,
Te adoleshencia;
Nga hovet e rinisë ngjallen kushedi.
Kësisoj bëhem babagjysh i ri.

KËTU NË MALËSI

Vjeshta i njeh mirë . . .
Huqet e dimrit.
Me shi e diell.

Nëpër kopshtije.
Nuk më kapi dora
Asnjë kokërr mollë . . .

Ah moj lozonjare,
Nga era xanxare,
Më çuditë fare.

Andej nga perëndimi,
Kuqelon qielli . . .
Dhe sonte s'ka shi.

Nata ulet e sertë.
Çdo bëjmë unë e ti,
Ne për zgjedhim modelin e ri.

poezi nga Bona Mulaj Lluka

Me rrezen pritmë...!

Me pate thënë do vij me erën
kur gjethesh kredhet si e lazduar
e në të ndodhtë të të prekë faqen
jam unë...që të puth malluar.

Me shiun do vij kur të vijë vjeshta
ti mos mbaj çadër të fshehësh kokën

e në të ndodhtë të të lag buzën
ç'e dua më t'ma falin botën.

Nëse të ulet mbi qerpik
një flokë bore në dhjetor
beso, ngurroj të të vij më rendë
që të puth syrin engjëllor.

Nëse e sheh një bulëz vese
mbi bar të njomë në fillim prillit
është lot i mallit të përveluar
që pabesisht iu shkeput syrit.

A rrezja e diellit në të prehtë synë
mos e ngri doren që të zësh ballin
janë puthje shpirti në mëngjes gushti
me diell ti nisa të shuaj mallin.

Se ti përhumur në tënden botë
tek shkruan mbremjesh e hedh kujtime
kushedi mëndja se çfarë të thotë
U humbëm...! Por jo e shtrenjta ime..!

Tash ika...!

N'aromë t'trupit, mos prit me m'gjet.
Jam shndrru n'pluhun, pa erë as dokë.
Dashtë sa jetën t'kam, e përtej saj, s'mujta ma.
Tash po iku ...
N'rrekat lshue qosheve t'shtratit, mos prit me m'ndi'.
Kërrkush ngushllim në t'pafrymët tesha sygjeti.
Vallzue kam me flad t'nadjes e t'zogut kangë.
Po kur m'kaploj vetmia, lypa me frymue nan tanden lkurë.
N'erë t'malit e n'ves t'barit i kam lan amanetet e mia.
E n'gurgullim t'prroit, ku randshëm merr teposhten , m'mendo.
Kam ik...si vala e lumit qi dy herë s'perplaset në t'njajtin gur.
E mas t'kam lan'...pendesën e përjetshme.
Pse s'dite, a s'dashte, a s'mujte...
Tash kam ik... Se s'mujta me dasht për të dy...!

Erdh' vjeshta i dashur....!

Dhe erdh' përsëri vjeshta i dashur.
Kapluar malli ma paska synë
Në veshë u bë kohë , s'i dëgjoj fjalët
Kur do rritesh, mendët kur do të vijnë
Se sa herë kjo stinë vinte, e dije!
Do të kërkoja të ngjisnim bjeshkët
e ti diku ulur rrije e veshtroje,
tek çmendurisht sodisja gjethet.
Kushedi sa e lojtur të jam dukur
kur shpesh të thoja , dhe pak të rrimë
Sot matanë perroit të kerkoj sytë
Le të më thuash "mendtë kur do të vijnë"
Dhe erdhi përsëri vjeshta i dashur
dhe përsëri unë mënd s'kam vënë
Tek bredh lazduar si t'kem tërë botën
tek eci harlisur, mbi gjethet rënë
Me gjethet, do ti nis të falat
Do thuash prapë, me keto mënd kjo
Me gjysëm zëri, tek dridhet buza
kapluar mallit ... do qash mbi to
erdhi përsëri vjeshta i dashur!

REDAKSIA

Kryeredaktor: Suela Ndoja
Redaktorë: Luigj Shyti, Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani, Lazër Kodra, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja

Mundësoi Botimin:
**GËZIM KOLË
ÇARDAKU**

